

# RAPORT PËR PAGESAT E UJIT NË KOSOVË

Ngarkesat e ujit, krahasimi me vendet e  
rajonit dhe kalkulimi sipas treguesve  
ekonomikë dhe mjedisorë në Kosovë

Prof.Dr.Driton Qehaja

TETOR, 2018

**AKRONIMET DHE SHKURTESAT**

|       |  |
|-------|--|
| AMBU  | Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore                  |
| AL    | Shqipëria  |
| ARPL  | Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore                    |
| ARRU  | Autoriteti Rregullativ i Ujit                            |
| ASK   | Agjencia e Statistikave të Kosovës                       |
| BE    | Bashkimi Evropian  |
| B&H   | Bosna dhe Hercegovina                                    |
| BPV   | Bruto Produkti Vendor                                    |
| BTBRU | Burimet Totale të Burimeve të Ripërtërishme të Ujërave   |
| CRO   | Kroacia  |
| DPL   | Divizioni i Pellgjeve Lumore                             |
| DU    | Departamenti i Ujërave                                   |
| GDP   | Gross Domestic Product (Prodhimi i Brendshëm Bruto)      |
| HEC   | Hidrocentral   |
| IEU   | Instrumenti ekonomike për menaxhimin e ujit              |
| IPVQ  | Institucionet e Përkohshme Vetë Qeverisëse               |
| KS    | Kosova   |
| KNU   | Këshilli Ndërmintor për Ujëra                            |
| KPMM  | Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve           |
| KRU   | Kompania Rajonale e Ujësjetës                            |
| LU    | Leja Ujore   |
| MAX   | Maksimale  |
| MES   | Mesatare   |
| MF    | Ministria e Financave                                    |
| MIN   | Minimale   |
| MK    | Maqedonia  |
| MMPH  | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor          |
| MNE   | Mali i Zi  |
| NA    | Nuk aplikohet  |
| OE    | Operatori ekonomik                                       |
| PPP   | Purchasing Power Parity ( Pariteti i Fuqisë së Blerjes ) |
| REF   | Referenca  |
| RREG  | Rregullore   |
| SLO   | Sllovenia  |
| SPU   | Struktura e Pagesave të Ujit                             |
| SSHU  | Strategjia Shtetërore për Ujëra                          |
| SRB   | Serbia   |
| UA    | Udhëzimi Administrativ                                   |
| VF    | Vendimi Financiar  |

**Tabela e Përmbajtjes**

|                |  |    |
|----------------|--|----|
| I.             | HYRJE .....  | 3  |
| II.            | METODOLOGJIA DHE STRUKTURA .....   | 4  |
| III.           | KAPITULLI I.....   | 7  |
| 1.             | Rishikimi i Udhëzimit Administrativ QRK- Nr. 02/2016 “Struktura e Pagesave të Ujit” .....                            | 7  |
| 2.             | Mangësitë e Udhëzimit Administrativ QRK- Nr. 02/2016 “Struktura e Pagesave të Ujit” .....                            | 9  |
| IV.            | KAPITULLI II.....  | 10 |
| 3.             | Sistemi i pagesave të ujit në rajon dhe krahasimi me ngarkesat aktuale në Kosovë .....                               | 10 |
| 3.1.           | Instrumentet ekonomike ujore në rajon.....   | 11 |
| 3.2.           | Sistemi i ngarkesave ujore / pagesave të ujit në Kosovë .....  | 11 |
| 3.3.           | Sistemi i ngarkesave ujore / pagesave të ujit në Shqipëri .....  | 13 |
| 3.4.           | Sistemi i ngarkesave ujore / pagesave të ujit në Maqedoni .....  | 15 |
| 3.5.           | Sistemi i ngarkesave ujore / pagesave të ujit në Serbi .....   | 17 |
| 3.6.           | Sistemi i ngarkesave ujore / pagesave të ujit në Kroaci.....   | 21 |
| 3.7.           | Sistemi i ngarkesave ujore /pagesave të ujit në Slloveni .....   | 26 |
| 3.8.           | Sistemi i ngarkesave ujore / pagesave të ujit në Malin e Zi.....   | 29 |
| 4.             | Dallimet e vendeve të rajonit sipas të ardhurave vjetore nga ngarkesat e ujit .....                                  | 33 |
| 5.             | Struktura e ngarkesave ujore (mesatare) të ujit në rajon.....  | 34 |
| 6.             | Ngarkesat e përdorimit/shfrytëzimit të ujit në rajon.....  | 34 |
| 7.             | Ngarkesat e mbrojtjes së ujit në rajon .....   | 36 |
| V.             | KAPITULLI III.....   | 39 |
| 8.             | Përlllogaritja / Analiza e tarifave për përdorimin e ujit, mbrojtjen e ujit dhe nxjerrjen e materialeve inerte ..... | 39 |
| 8.1.           | Kategorizimi dhe klasifikimi i tarifave ujore në rajon .....   | 39 |
| 8.2.           | Ngarkesat për përdorimin e ujit .....  | 40 |
| 8.3.           | Tarifa për mbrojtjen e ujit .....  | 40 |
| 8.4.           | Tarifa për nxjerrjen e materjaleve inerte .....  | 41 |
| 9.             | Analiza e treguesve/parametrave ekonomik dhe mjedisor të vendeve të rajonit dhe krahasimi i tyre .....               | 41 |
| 9.1.           | Popullsia .....  | 41 |
| 9.2.           | Siperfaqja.....  | 42 |
| 9.3.           | GDP nominal dhe PPP në total dhe për capita .....  | 42 |
| 9.4.           | Ngarkesat e ujësjes dhe kanalizimit .....  | 45 |
| 9.5.           | Paga mesatare në Kosovë dhe vendet e Rajonit .....   | 46 |
| 9.6.           | Disponueshmëria e ujit në vendet e rajonit .....   | 47 |
| VI.            | KAPITULLI IV.....  | 49 |
| 10.            | Verzioni i Draft – Rregullores për ngarkesat e ujit .....  | 49 |
| 11.            | Referencat.....  | 57 |
| SHTOJCAT ..... | 60   | 60 |

## I. HYRJE

Uji është një element thelbësor i zhvillimit ekonomik në Republikën e Kosovës. Përmirësimi i menaxhimit të ujit mund të sjellë përfitime të mëdha për shëndetin, bujqësinë dhe prodhimin industrial, duke ofruar mundësi për rritje ekonomike dhe drejtësi sociale.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është që të propozoj një draft Udhëzim Administrativ (UA) për strukturën e pagesave të ujit bazuar në Instrumentin Ekonomik të Ujit (IEU)<sup>1</sup> d.m.th. një analizë reale dhe krahasuese të ngarkesave ujore në rajon të llogaritura në parametrat e ekonomisë së vendit (Republika e Kosovës). Raporti analizon variablat socioekonomike dhe mjedisore të rajonit (kryesisht burimeve ujore) dhe i krahason ato në kontekst të gjendjes ekonomike në Kosovë, në mënyrë që përcaktimi i ngarkesave ujore të jetë konform Strategjisë Shtetërore të Ujërave të Kosovës 2017-2036.

IEU (Instrumenti ekonomik për menaxhimin e ujit) është dizajnuar për t'iu përshtatur politikave në sektorin e ujërave dhe karakteristikave të tregut kosovar. Raporti përmes IEU jep propozim për ngarkesë apo çmimin e ujit duke u bazuar në disponueshmërinë e ujit dhe vlerën e saj ekonomike. Konkretisht, ngarkesa apo çmimi i ujit është përcaktuar duke zbërthyer programin e investimeve publike në sektorin e ujërave në të hyrat e pagesave të ujit përmes mbulimit të kostove të shërbimit dhe investimeve. Përpos analizes së kalkulimit të ngarkesave ujore, raporti gjithashtu përfshinë një analizë problemeve dhe mangësive ligjore dhe institucionale në zbatimin e Udhëzimeve Administrative në fuqi, duke ofruar rekomandime për zgjidhjen e problemit.

Udhëzimi Administrativ për strukturat e pagesave të ujit (UA Nr.06/2006) ka përcaktuar një nivel kompezimi me të cilin detyrohen të gjithë personat fizikë dhe juridikë që të bëjnë pagesa dhe kompezime në lidhje me shfrytëzimin e ujit, shkarkimet e ujit dhe nxjerrjen e inerteve, bazuar në parimin “ndotësi dhe shfrytëzuesi paguan”. Niveli i kompezimi është

---

<sup>1</sup> Sipas Kombeve të Bashkuara: ([http://www.un.org/waterforlifedecade/green\\_economy\\_2011/pdf/session\\_1\\_economic\\_instruments.pdf](http://www.un.org/waterforlifedecade/green_economy_2011/pdf/session_1_economic_instruments.pdf)) IEU është një instrument i politikës ekonomike për menaxhimin e ujërave që paraqet një grup incentivash të dizajnuara për të prodhuar një ndryshim të dëshiruar në vendimet individuale dhe kooperative në ato aktivitete në të cilat shërbimet e ujit përdoren në ekonomi.

Ilogaritur bazuar pjesërisht në parametrat e ekonomisë vendore dhe pjesërisht të vendosur në baza ad hoc. UA (Nr.06/2006) u rishikua dhe në mars të vitit 2016 hyri në fuqi UA (Nr. 02/2016)<sup>2</sup>. Në këtë UA "Krahasimi rajonal" ishte qasja dominuese në përcaktimin e ngarkesave ujore. Vendosja e ngarkesave ujore në UA (Nr. 02/2016) është bërë në mënyrë nominale, duke mos marr parasysh gjendjen socioekonomike dhe mjedisore në rajon (kryesisht burimeve ujore) - si pjesë kryesore e metodologjisë së vendosjes së lartësisë së ngarkesës. Pra, ngarkesa ujore është caktuar duke krahasuar nominalisht ngarkesat ujore në rajon për të vendosur një ngarkesë ujore në Kosovë.

Në të dyja rastet, UA ka dështuar në zbatimin e saj. Niveli i borxheve të parashtruara të ujit nuk përputhej siç duhet me implikimet/realitetet ekonomike. Gjatë takimit të tij të 7-të, Këshilli Ndërmintor i Ujrave kërkoi nga MMPH-në dhe MF-në që të zbatojë Udhëzimin Administrativ (UA) për strukturën e pagesave të ujit, përkatësisht vendimin 7.1 dhe në përputhje me dokumentin e politikave ujore (paragrafi 1 në faqen 12 ose deklarata e politikës: koncepti i ndotësve paguan, në faqen 13).

Këshilli Ndërmintor i Ujrave (KNU) ndërmori një studim mbi të ardhurave nga pagesat për ujë dhe shpejt u bë e qartë se Kosova duhet të llogarisë dhe harmonizojë nivelin e ngarkesave ujore bazuar në situatën ekonomike në vend dhe bazuar në gjendjen e përgjithshme të burimeve ujore. Ndërkohë, qeveria fillimisht ofroi një amnisti për një kategori të përdoruesve të ujit (kompanitë e ambalazhuesve) dhe më vonë e shfuqizoi atë vendim për të zbutur borxhin në vend të amnistisë. MMPH ka kërkuar për të vazhduar studimin me qëllim të hartimit të një UA të ri të mirëanalizuar për strukturën e pagesave të ujit, duke përfshirë një analizë më të thellë të treguesve socioekonomikë dhe mjedisore a që duhet ta udhëzojnë përcaktimin e ngarkesave ujore në Kosovë.

## II. METODOLOGJIA DHE STRUKTURA

---

<sup>2</sup> Në vitin 2013, hyn në fuqi Ligji i ri i Ujrave (nr. 04/L-147) ku çështjet e financimit rregullohen nga neni 85-92. Sipas nenit 91, Qeveria në mars të vitit 2016 miraton aktin nënligjor për Strukturën e Pagesave të Ujit, (UA Nr 02/2016).

## Metodologjia

Qasja e hulumtimit të rishikimit të instrumentit ekonomik ujor (aktit nënligjor Struktura e Pagesave të Ujit) është bërë sipas metodës kualitative dhe kuantitative, duke analizuar faktorët, proceset dhe elementet tjerë relevant si dhe lidhjet e raporteve midis tyre në sferën e pagesave të ujit në Kosovë, gjithnjë duke u bazuar në legjislacionin aktual. Raporti i përkushton fokus të veçantë zbatimit të ligjit në fushën e instrumenteve ekonomike (ngarkesave ujore) në Kosovë.

Për hartimin e këtij raporti është konsultuar një gamë e gjërë e literaturës, duke filluar nga databazat e OECD, IMF, WB, dokumentet e publikuara nga institucionet relevante në Kosovë, si dhe në 7 vende të rajonit (Shqipërinë, Maqedoninë, Bosnën, Serbinë, Kroacinë, Slloveninë dhe Malin e Zi) në lidhje me ligjet e ujërave, statistikat ujore dhe legjislacione të ndryshme relevante.

Metoda e analizës reale paraqet krahasimet në mes Kosovës dhe shteteve të rajonit në aspektin e instrumentit ekonomik ujore duke peshuar (ponderuar) elementet krahasuese, veçoritë e përbashkta dhe/ose diferencat në mes të Kosovës dhe 7 vendeve të rajonit (Shqipërinë, Maqedoninë, Bosnën, Serbinë, Kroacinë, Slloveninë dhe Malin e Zi). Fushat analitike dhe krahasimore e ngarkesave ujore përfshinë:

- legjislacionet në fuqi të vendeve të rajonit
- Organet kompetente për menaxhimin e ujit
- Treguesit / parametrat ekonomik të vendeve ( popullsia, sipërfaqja, të ardhurat bruto dhe neto, GDP nominale dhe PPP në total, GDP nominale dhe PPP për kokë banori etj
- Treguesit / parametrat mjedisor ( disponueshmeria mesatare e ujit për kokë banori në vit, trifat e ujesjellesve dhe kanalizimeve, përqindja e ujit etj )
- Lartësia e ngarkesës të përdorimit (shfrytëzimit) të ujit, mbrojtjes së ujit dhe nxjerrjes së matërxjelleve inerte nga të gjitha vendet e rajonit
- Të ardhurat mesatare vjetore nga ngarkesa e përgjithshme të ujit dhe elemente të tjera

Të gjitha elementet e lartëpërmendura janë të paraqitura në mënyrë tabelare dhe grafike dhe të komentuar me përshkrime analitike.

Përcaktimi i lartësisë së ngarkesave ujore sipas kategorive: përdorimi i ujit, mbrojtja e ujit dhe nxjerrja e inerteve, është bazuar në metodën mbulimit të kostos së investimeve në fushën e ujërave sipas ligjit për Ujërat e Kosovës dhe Strategjisë Shtetërore për Ujërat e Kosovës. Kalkulimi i ngarkesave ujore fillon nga baza e investimeve vjetore të sektorit të ujërave, bazuar në Strategjinë Shtetërore të Ujërave të Kosovës 2017-2036<sup>3</sup> sipas burimeve të investimit. Mbulimi i kostos së një pjese të investimeve është paraparë të arrihet përmes ngarkesave nga shfrytëzimi i ujit, mbrojtja e ujit dhe nxjerrja e materialeve inerte, sipas Ligjit për Ujërat e Kosovës.

Zbërthimi i një pjese të investimeve për infrastrukturën ujore në mbledhjen e pagesave është strukturuar sipas përqindjes së investimit nga kategoria e caktuar e mbledhjes së pagesave nga operatorët ekonomik në periudhë 1 vjeqare. Struktura e pagesave të përgjithshme të ujit e përcakton lartësinë e ngarkesave ujore në bazë të përqindjes investuese nga kategoria e mbledhjes së të hyrave. Këtë përqindje e vendos për çdo vit MMPH sipas politikave zhvillimore të nënsektorëve të veçantë të ujërave në bazë të destinimeve të caktuara. Në çdo ngarkesave ujore të secilës kategori të strukturës së përgjithshme merret parasysh krahasimi i parametrave ekonomik dhe mjedisor.

### **Struktura**

Raporti është i strukturuar në katër kapituj. Fillimisht në **Kapitullin I**, *Rishikimi i Udhëzimit Administrativ QRK- Nr. 02/2016 “Struktura e Pagesave të Ujit”*, paraqitet historiku i legjislacionit ujqor, nga formimi i MMPH, hyja ne fuqi Ligji i Ujërave Nr. 24/2004 në vitin 2004 dhe deri tek vendimi i Kryeministrit të Kosovës për falje të borjeve e pastaj revokimi i të njejtit vendim (falja e borxheve të kompanive amabalazhuese). Në Kapitullin I, gjithashtu analizohen UA Nr.06/2006 dhe UA Nr 02/2016, përkatësisht mangësitë që përmbajnë dhe mungesa e zbatueshmerisë së këtyre ligjeve, që rezultoi në grritjen e borxheve si pasojë e mos kryerjes së obligimeve përkatëse financiare.

Në **Kapitullin II**, *Sistemi i pagesave të ujit në rajon dhe krahasimi me ngarkesat ujore aktuale në Kosovë*, analizohen avantazhet e instrumenteve ekonomike ujore në raste kur janë të dizajnuara në mënyrë të rregullt dhe transparente, dhe objektivat e arritshme përmes

<sup>3</sup> Strategjia Shtetërore për Ujëra (SSHU) është një nga dokumentet kryesore të planifikimit të resurseve ujore në Republikën e Kosovës, e cila është hartuar në përputhje me Nenin 31 të Ligjit për Ujërat e Kosovës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.10, 29 prill 2013, Prishtinë). Qeveria e Kosovës synon që përmes këtij dokumenti të adresojë dhe orientojë zhvillimet politike, operative dhe investive në sektorin e ujërave për periudhën 20 vjeqare. SSHU përcakton objektivat strategjike dhe drejtimet e zhvillimit të resurseve ujore duke filluar nga gjendja ekzistuese e sektorit të ujërave, shtjellimin e kërkesave, strukturat menaxhuese, detyrimet ndërkombëtare, kërkesat për mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes dhe cilësisë së ujërave, mbrojtjen nga ujërat dhe mbrojtjen e ekosistemeve ujore.

tyre. Pastaj, shqyrtohen profilet e shteteve; Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë, Bosnjës, Kroacisë, Sllovenisë dhe Malit të Zi, në aspektin e rregullimeve institucionale, ligjore dhe politikbërëse të sistemeve të ngarkesave ujore në rrafshin e resurseve ujore. Gjithashtu janë hulumtuar treguesit kryesorë ekonomikë dhe mjedisorë të vendeve të lartpërmendura në raport me Kosovën.

Ne **KAPITULLI III**, *Përlllogaritja / Analiza e ngarkesave ujore për përdorimin e ujit, mbrojtjen e ujit dhe nxjerrjen e materialeve inerte*, bëhet kategorizimi dhe klasifikimi i ngarkesave ujore në rajon, për qellim krahasimor, në menyre që të arrihet objektiva e krijimit të një mekanizmi funksional dhe institucional të sistemit të pagesave të ujit në Kosovë.

Ne fund, **KAPITULLI IV**, paraqet verzionin e Draft Rregullores për ngarkesat ujore. Raporti jep verzionin e aktit nënligjor “*Rregullore për Strukturën e Pagesave të Uji*” të bazuar plotësisht në Ligjin e Ujërave dhe pjesërisht në direktivën Kornizë për Ujëra. Ky verzion është i bazuar në elementet më të mira të shteteve të rajonit dhe parametrat ekonomikë të Kosovës. Akti nënligjor përmban metodën e llogaritjes, procedurën, afatet dhe kontrollin e detyrimet.



### III. KAPITULLI I

#### 1. Rishikimi i Udhëzimit Administrativ QRK- Nr. 02/2016 “Struktura e Pagesave të Ujit”

Menjëhere pas themelimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) në vitin 2002, Departamenti i Ujërave hartoj Ligjin e Ujërave të Kosovës, i cili hyri në fuqi në vitin 2004 (Ligji i Ujërave Nr. 24/2004). Në vitin 2006, derivuar nga Ligji për Ujërat e Kosovës, si akt nënligjor u hartua dhe hyri në fuqi Udhëzimi Administrativ për Strukturën e Pagesave të Ujit Nr.06/2006, me të cilin detyrohen të gjithë personat fizikë dhe juridikë të bëjnë pagesa dhe kompezime në lidhje me shfrytëzimin e ujit, shkarkimet e ujit dhe nxjerrjen e inerteve, bazuar në parimin “ndotësi dhe shfrytëzuesi paguan”. Nga hyrja në fuqi, zbatimi i UA 06/2006 për Strukturën e Pagesave të Ujit ka qenë minimal duke shkaktuar që problemet në sektorin e ujërave të akumulohen për vite me radhë.<sup>4</sup>

Në vitin 2013, hyn në fuqi Ligji i ri i Ujërave (nr. 04/L-147) ku çështjet e financimit rregullohen nga neni 85-92. Sipas nenit 91, Qeveria miraton aktin nënligjor për Strukturën e Pagesave të Ujit, në mars 2016 (UA Nr 02/2016). Por, edhe ky UA nga hyrja në fuqi e deri më sot, nuk është duke u zbatuar në nivelin e duhur.

Në vitin 2015, MMPH formon një grup punues Ministrorë për të verifikuar dhe finalizuar bazën e të dhënave lidhur me lejet ujore, pagesat dhe obligimet e mbetura. Në raportin e Grupit Punues të MMPH<sup>5</sup> (i përbërë nga 8 nënpunës/e të Ministrisë ) që është përfunduar në Mars të vitit 2016, janë dhënë detaje të moszbatimit të UA Nr 02/2016 si dhe UA Nr 06/2006. Në këtë raport janë të paraqitura obligimet, pagesat dhe borxhet për të gjitha kategoritë e kompanive sipas klasifikimit të veprimtarive dhe shfrytëzimit të ujit në të cilat përfshihen: kompanitë publike të furnizimit me ujë, kompanitë e kultivimit të peshkut, ambalazhuesit, hidrocentralet dhe kompanitë tjera private, si dhe kompanitë e shkarkimit të ujërave.

<sup>4</sup> Për detaje me të hollësishme shih Raportin: Të ardhurat nga pagesat e ujit, 2017, [http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Te\\_ardhurat nga\\_pagesat\\_e\\_ujit.doc](http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Te_ardhurat nga_pagesat_e_ujit.doc)

<sup>5</sup> Raporti përfundimtar i Grupit Punues Ministror për verifikimin dhe finalizimin e bazës së të dhënave lidhur me lejet ujore, pagesat dhe obligimet e mbetura, gjetet në arkivën MMPH.

Gjithsej obligimet, sipas raportit të Grupit Punues nga MMPH nga viti 2006-2015, janë 2,036,895.17 € pa përfshirë Ambalazhuesit. Nga viti 2006 deri në vitin 2015, gjithnjë sipas të njëjtit raport, pagesat kanë qenë 648,528.46 €.

Në vitin 2017, hartohet raporti rreth “Të ardhurave nga Pagesat e Ujit” nga Këshilli Ndërmarrës për Ujëra.<sup>6</sup> Raporti analizon tërë periudhën nga hyrja në fuqi e UA 06/2006 dhe jep alternativa të zgjidhjes së problemit që është akumuluar për vite me radhë (kryesisht nga moszbatueshëria e ligjit në aspektin e pagesave të ujit). Raporti konstaton se mosndërmarrja e masave ligjore me kohë nga MMPH ka vështirësuar në masë të madhe zgjidhjen e këtij problemi dhe ka prodhuar për pasojë humbjen e të hyrave financiare tejet të larta.<sup>7</sup>

Në po të njëjtin vit, me datë 03.10.2017, Kryeministri i Kosovës, aprovon faljen e borxheve nga ambalazhuesit e ujit me Vendim të posaçëm.<sup>8</sup> Pas këtij Vendimi, MMPH formon grup punues për ndryshimin dhe plotësimin e UA 02/2016 dhe njëkohsisht zbatimin e Vendimit të Qeverisë, për faljen e borxheve dhe pa kaluar pak muaj, kryeministri revokon Vendimin për faljen e borxheve me nr. 13/06 dhe nxjerr Vendim tjetër me Nr. 15/33 me të cilin “faljen e borxheve” e zëvendëson me fjalën “lehtësira” dhe pas këtij veprimi, nuk dihet se çfarë hapash ka ndërmarrë MMPH me grupin punues për plotësim-ndryshimin e UA 02/2016 dhe zbatueshmëria e këtij UA mbetet në nivelin e njëjtë.<sup>9</sup>

<sup>6</sup> Qëllimi kryesor i këtij raporti ishte që të ofrojë një vlerësim faktik të detyrimeve financiare që rrjedhin nga (mos) pagesat e ujit dhe të ofrojë rekomandime për zgjidhjen e problemit. Ky raport për të ardhurat nga (mos) pagesat e ujit jep një analizë të detajuar mbi implementimin e Udhëzimit Administrativ “Struktura e Pagesave të Ujit” 06/2006 dhe 02/1016 për periudhën 2008-2016. Dokumentet kryesore që kanë shërbyer për këtë raport janë: Analiza e vitit 2013 e hartuar nga Divizioni për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore në kuadër të MMPH-së dhe Raporti Ministror i haruar nga Grupi punues i MMPH-së. Mbi bazën e këtyre dokumenteve si dhe legjisllacionit në fuqi që rregullon çështjen e ngarkesave (tarifave) ujore, është ndërtuar analiza e përlllogaritjeve për të gjitha kategoritë e përdorimit të ujit si, llojet e kompanive, klasifikimit të tarifave etj. Për detaje me të hollësishme shih: Raporti – Të ardhurat nga pagesat e ujit, 2017.

[http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Te\\_ardhurat nga\\_pagesat\\_e\\_ujit.doc](http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Te_ardhurat nga_pagesat_e_ujit.doc)

<sup>7</sup> Në shumicën e rasteve, kompanitë private, në veçanti ato të ambalazhimit të ujit, nuk kanë raportuar për sasinë e ujjitë harxhuar dhe të shitur ashtu siç kërkohet me kushte të lejeve ujore. Ministria, disa herë ju kishte kërkuar raporte për deklarimet e ujit të shfrytëzuar dhe të shitur, mirëpo përkundër mos-raportimit nga ana e kompanive, ministria nuk kishte ndërmarrë masa të tjera konform ligjit. Gjithashtu edhe Inspektorati i MMPH-së, kishte realizuar disa vizita inspektuese nëpër kompani të ndryshme, por edhe kjo kishte rezultuar pa efekte të pritshme. Sipas nenit 90 të Ligjit për Ujërat, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet që për çdo vit t’i dërgoj raport qeverisë – MF, për realizimin e të hyrave nga pagesat e ujërave. Sipas analizës tonë dhe përgjigjeve që kemi marrë nga Ministria e Financave, MMPH asnjëherë nuk ka raportuar për realizimin e pagesave apo mos pagesave nga ujërat. Raporti – Të ardhurat nga pagesat e ujit, 2017

[http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Te\\_ardhurat nga\\_pagesat\\_e\\_ujit.doc](http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Te_ardhurat nga_pagesat_e_ujit.doc)

<sup>8</sup>Vendim nr. 13/06. [http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_së\\_6-të\\_të\\_Qeverisë\\_së\\_Republikës\\_së\\_Kosovës\\_2017..pdf](http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_së_6-të_të_Qeverisë_së_Republikës_së_Kosovës_2017..pdf)

<sup>9</sup> Vendim nr. 15/33. [http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimi\\_i\\_Mbledhjes\\_së\\_33-të\\_të\\_Qeverisë\\_së\\_Republikës\\_së\\_Kosovës\\_2018.pdf](http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimi_i_Mbledhjes_së_33-të_të_Qeverisë_së_Republikës_së_Kosovës_2018.pdf)

## 2. Mangësitë e Udhëzimit Administrativ QRK- Nr. 02/2016 “Struktura e Pagesave të Ujit”

Bazuar në analizat, raportet dhe dokumentet e tjera që kanë pasur për subjekt trajtimin e UA të kaluar por edhe ato aktual për “Strukturën e Pagesave të Ujit” janë evidentuar mangësi dhe si pasojë zbatueshmeria e tyre nuk është e nivelit të kënaqshëm. Në Strategjinë Shtetërore për Ujërat e Kosovës është evidentuar se mbledhja e pagesave nga ujërat është e ulët. Si arsyeshmëri për këtë nivel të ulët të pagesave, strategjia numëron: ngarkesat e ulëta; konsumatorët ilegalë të ujit (të pafaturuar) dhe nivel i ulët i arkëtimit të të hyrave.<sup>10</sup>

Sipas një analize të brendshme nga DU - MMPH në mesin e vitit 2013, rezultonte që nga viti 2008-2013, Ministria nuk ka zbatuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me të hyrat nga pagesat e ujërave dhe moszbatimi i ligjit rrjedhimisht kishte dëmtuar buxhetin për mbi 100 milionë euro.<sup>11</sup> Gjithashtu edhe raportet e auditimit të jashtëm e cekin si sfidë dhe humbje potenciale e financiare, mosarkëtimin e të hyrave nga sektori i ujërave.<sup>12</sup>

Mangësitë kryesore të Udhëzimit Administrativ për “Strukturën e Pagesave të Ujit” me Nr. 02/2016, të cilat janë evidentuar gjatë analizës janë:

- Emrërtimi aktit nënligjor, Udhëzim Administrativ dhe përmes këtij titullimi zbehja e fuqisë ligjore;
- Vendosja e përkufizimeve të pasqaruara dhe të përsëritura nga Ligji i Ujërave;
- Përcaktimi i ngarkesave ujore në mënyrë paushalle, pa asnjë analizë dhe kalkulim paraprak dhe të argumentuar sipas parametrave ekonomikë/mjedisorë dhe
- Mungesa e metodës së llogaritjes, procedurave, afateve dhe kontrollit të detyrimit dhe

<sup>10</sup>Strategjina Shtetërore e Ujërave në Kosovës (SSHUK), Të ardhurat e sektorit të ujërave, faqe 51 [http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia\\_Shteterore\\_e\\_Ujrave\\_\\_shqip.pdf](http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Shteterore_e_Ujrave__shqip.pdf)

<sup>11</sup>Analiza e Mosveprimit të DU-së, Besim Dobruna, 2013 Dokumenti gjetet në arkivën e MMPH.

<sup>12</sup>Raport I Auditimit, 2016, faqe 16, <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/07/RaportiAuditimit.MMPH.2016.Shqip.693321.pdf>

## IV. KAPITULLI II

### 3. Sistemi i pagesave të ujit në rajon dhe krahasimi me ngarkesat ujore aktuale në Kosovë

Instrumente ekonomike të ujit (IEU) janë të njohura në të gjithë botën, përfshirë këtu dhe vendet e rajonit. Në një botë me kërkesën gjithnjë në rritje të ujit dhe rënien e disponueshmërisë dhe / ose rritjen e varësisë së jetesës nga uji, ku rreziqet që lidhen me ujin janë në rritje, ku ndryshimet klimatike kërcënojnë të shkatërrojnë dekada përpjekjesh globale për zhvillim dhe rritje ekonomike, mënyra e vetme për qëndrueshmërinë është implementimi i Instrumenteve ekonomike të ujit që përbën një ndëthuarje të ndërsjellë të instrumenteve dhe politikave ekonomike me ato të ambientit. Në këtë përzierje të politikave, Instrumentet Ekonomike të Ujit (IEU-it) janë kompetenca më e mirë për të nxitur shpërndarjen dhe përdorimin efikas të ujit, zvogëlimin e aktiviteteve të dëmshme dhe të rris ndikimet positive të ujit në komunitete dhe mjedise, si dhe mbrojtjen e kapitalit natyror (mjedisor). Ato janë një mjet për të korrigjuar sinjalet e tregut në mënyrë që të përcjellin kostot e eksternaliteteve tek akterët ekonomikë (individë si dhe firma). Sa i përket politikave të ujit, instrumentet ekonomike të ujit përfshijnë, ndër të tjera, edhe rregullore si ato që krijojnë kushte të tregut (leje të tregtueshme), pagesa për shërbimet publike, pagesa për shërbimet e ekosistemit dhe pagesa të transfertave siç janë stimujt në bazë të taksave, honorarëve dhe subvencioneve. Aktualisht, sfidë e re dhe specifike globale janë politikat klimatike që paraqesin një ndërthurje të politikave të ujit me politikat e cilësisë së ajrit dhe energjisë.

Nëse IEU-ve është transparent dhe të ardhurat janë të destinuara për përdorime të lidhura me shërbimin ose për zbutjen e ndikimeve nga përdorimi i ujit, ngarkesat për shfrytëzimin e ujit potencialisht synojnë objektiva të ndryshme si:

- Rishpërndarjen e shpenzimeve të operatorëve të shërbimit të ujit për shërbimet e lidhura me ujin midis përdoruesve, mbulojnë kostot për ofrimin e shërbimeve;
- Shpërndarja e kostove sociale të përdorimit të burimeve, për shembull, kostot mjedisore midis përdoruesve;
- Atribuimin e përdorimit të ujit në mënyrën ekonomikisht më efektive të përdorimit sipas aftësisë së tyre për të paguar.

Objektivat e lartpërmendura janë më të përgjithësuara dhe potencialisht synojnë arritjen e racionalizimit të përdorimit të ujit duke pasur parasysh rënien e disponueshmërisë dhe/ose besueshmërisë, ku rreziqet që lidhen me ujin janë në rritje.

Përmes politikës së kompezimeve ujore, në veçanti, mund të arrihen dy objektiva:

- Të mbulohet kostoja e prodhimit të ujit që paguhet nga sektori publik dhe
- Të dërgohet një sinjal i rëndësishëm për të sensibilizuar nivelin e mungesës së ujit dhe për të ndryshuar sjelljen e konsumatorëve.

Përcaktimi i ngarkesave ujore, përmes politikave mjedisore legjisacionit, veçanërisht atë ujqor, në Regjionin e Ballkanit është i shtrirë sipas specifikave të disponueshmërisë së ujit dhe parametrave ekonomikë e financiarë si dhe mjedisorë të rregullimeve dhe politikave shtetërore.

### 3.1. Instrumentet ekonomike ujore në rajon

Vendet e rajonit (Ish – Jugosllavisë) përfshirë edhe Shqipërinë, janë objekt i analizës dhe krahasimit me republikën e Kosovës. Mekanizmat e politikave ujore shtetërore në vende si: Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Serbi, Bosnjë, Kroaci, Slloveni dhe Mali i Zi, janë analizuar dhe trajtuar veç e veç në aspektin e rregullimeve institucionale, ligjore dhe politikbërëse të sistemeve tarifore (ngarkesave) në fushën e resurseve ujore. Gjithashtu janë hulumtuar treguesit kryesorë ekonomikë dhe mjedisorë të të gjitha vendeve në raport me Kosovën.

### 3.2. Sistemi i ngarkesave / pagesave të ujit në Kosovë

Sistemi i ngarkesave ujore (tarifave ujore) si politikë mjedisore në Kosovë, aktualisht është i rregulluar mbi bazën e dispozitave ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, Kapitulli 12 – Financimi.<sup>13</sup>

Sipas dispozitave ligjore të këtij kapitulli, nga neni 85-92 i Ligjit, përcaktohet:

- Burimi i financimit në fushën e ujërave;
- Pagesa për shfrytëzimin, shkarkimin në ujëra dhe nxjerrjen e materialeve inerte;
- Detyrimi për pagesat ujore;
- Destinimi i mjeteve nga pagesat;
- Realizimi i mjeteve nga pagesat;
- Përcaktimi i lartësisë së pagesës për shfrytëzimin e ujërave dhe
- Buxheti

<sup>13</sup> LIGJI Nr. 04/L-147 PËR UJËRAT E KOSOVËS, Kapitulli 12, Financimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>

Dispozita kryesore, sa i përket aspektit ligjor në krijimin e politikave ujore të hartimit të sistemit tarifor (ngarkesave ujore), është “Përcaktimi i lartësisë së pagesës për shfytëzimin e ujërave” neni 91, paragrafi 1 dhe 2 citat: 1. Qeveria, me akt nënligjor do të themelojë strukturën e pagesave të ujit, në pajtim me këtë ligj. 2. Akti nga paragrafi 1. i këtij neni, do të ketë për bazë parimet, “ndotësi paguan” dhe “shfrytëzuesi paguan”<sup>14</sup>. Mbi bazën e kësaj dispozite, Qeveria e Kosovës, në Mars të vitit 2016 ka nxjerrë: Udhëzimin Administrativ QRK- Nr. 02/2016 “Struktura e Pagesave të Ujit”

Kosova nga viti 2006, në aspektin ligjor e ka të rregulluar mekanizmin e pagesave të ujit përmes Udhëzimit Administrativ për Strukturën e Pagesave të ujit 06/2006. Në vitin 2016 ndryshohet dhe aktualisht në fuqi është UA SPU 02/2016. Nëse e analizojmë zbatimin e këtij instrumenti në treguesit e të hyrave vjetore mesatare nga pagesat e ujit, dhe krahasojmë me mesataren e të hyrave të rajonit, rezulton se vetëm 0.27% të mesatarës së të hyrave të rajonit, Kosova arrin t’i inkasojë.

Institucioni kompetent për mbledhjen e të ardhurave nga ngarkesat ujore sipas Udhëzimit Administrativ QRK- Nr. 02/2016 “Struktura e Pagesave të Ujit” është MMPH, ARPL në bashkëpunim me MF.<sup>15</sup> Mjetet e grumbulluara janë të ardhura të buxhetit të Kosovës.<sup>16</sup> Të ardhurat në Republikën e Kosovës në mesatare vjetore janë rreth 70 mijë \$ nga ngarkesat e shfrytëzimit të ujit dhe 160 \$ nga ngarkesat e mbrojtjes së ujit (Tabela 1). Deri më tani nga ngarkesat e nxjerrjes së materjaleve inerte, Kosova nuk arkëton fare. Në mesatare nga 2 llojet e pagesave gjithësej në buxhetin e shtetit mesatarisht arkëtohen rreth 35 mijë \$. Niveli i arkëtimit të të hyrave të Kosovës, arrin vetëm 0.27 % të mesatares së të ardhurave në rajon. Të dhënat për të ardhurat vjetore u referohen raportit të vitit 2017 – të ardhurat nga pagesat e ujit.<sup>17</sup>

<sup>14</sup> LIGJI Nr. 04/L-147 PËR UJËRAT E KOSOVËS, Neni 85-92: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>

<sup>15</sup> UDHËZIM ADMINISTRATIV QRK-Nr. 02/2016 PËR STRUKTURËN E PAGESAVE TË UJIT, neni 9 parag.1 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15081>

<sup>16</sup> Po aty, neni 9 parag.2

<sup>17</sup> Për detaje me të hollësishme shih Raportin: Të ardhurat nga pagesat e ujit, 2017, [http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Te\\_ardhurat nga\\_pagesat\\_e\\_ujit.doc](http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Te_ardhurat nga_pagesat_e_ujit.doc)

Tabela 1: Të ardhurat nga pagesat e ujit në Kosovë, dhe krahasimi i me mesataren e rajonit

| Te ardhurat mesatare vjetore ne Kosove nga tarifat e ujit |                                 |                                |                    | Shteti             | Te ardhurat mesatare vjetore nga tarfat e ujit [€] |
|---|---------------------------------|--------------------------------|--------------------|--------------------|--|
| Vitet   | Tarifa e perdorimit te ujit [€] | Tarifa e mbrojtjes se ujit [€] |                    |                    |  |
| 2008  | 69,457.00                       | 160.56                         |                    | Shqiperia          | 1,600,000.00                                       |
| 2009  | 69,457.00                       | 160.56                         |                    | Serbia             | 10,966,666.67                                      |
| 2010  | 69,457.00                       | 160.56                         |                    | Kroacia            | 22,395,833.33                                      |
| 2011  | 69,457.00                       | 160.56                         |                    | Slllovnia          | 29,296,710.53                                      |
| 2012  | 69,457.00                       | 160.56                         |                    | Mali i Zi          | 311,111.11   |
| 2013  | 69,457.00                       | 160.56                         |                    | Mesatarja ne rajon | 12,914,064.33                                      |
| 2014  | 69,457.00                       | 160.56                         | Total / mesatare/€ | %                  | 0.27   |
| 2015  | 69,457.00                       | 160.56                         | <b>34,808.78</b>   |                    |  |
|   | 69,457.00                       | 160.56                         |                    |                    |  |

**Burimi:** Raporti "Te ardhurat nga pagesat e ujit" 2017

### 3.3. Sistemi i ngarkesave / pagesave të ujit në Shqipëri

Në Shqipëri sektori i ujërave është i rregulluar sipas LIGJIT Nr. 111/2012 PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE të vitit 2012 dhe plotësim-ndryshimit të Ligjit Nr. 6/2018.<sup>18</sup>

Organet kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore janë:

1. Organet Qendrore për Administrimin dhe Menaxhimin e Burimeve Ujore janë:

- a) Këshilli i Ministrave;
- b) Këshillit Kombëtar i Ujit;
- c) Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;

2. Organet vendore për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore janë:

- a) Këshillat e Baseneve Ujore;
- b) Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore, degë të AMBU-së

Ngarkesat ujore në Shqipëri miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Ngarkesat e përdorimit të ujit dhe shkarkimeve të lëngëta kategorizohen në:

- furnizim me ujë – Njësia është m<sup>3</sup> i nxjerrë;
- prodhim të energjisë elektrike - Njësia është kË/h i prodhuar në %;

<sup>18</sup> LIGJI Nr. 111/2012 PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE,  
<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2030/LIGJ%20nr.%206-2018,%20date%208.2.2018.pdf>

- për ujitje në bujqësi dhe blegtori – Njësia është Ha për bujqësi dhe m<sup>3</sup> për blegtori;
- për akuakulturë – Njësia është Kg peshk i shitur;
- ujëra kurative termominerale, minerale dhe gjeotermale – Njësia është vaska/muaj;
- turistike – Njësia është m<sup>3</sup> dhe
- për shfrytëzim materialesh inerte – Njësia është % e vlerës së shitur.<sup>19</sup>

Në Republikën e Shqipërisë ngarkesat ujore janë përcaktuar sipas qëllimit të përdorimit dhe ngarkesat sillen nga 0.01Lek/m<sup>3</sup> (0.0001 €/m<sup>3</sup>) ujësjellës që furnizon një ose disa fshatra, të cilin ujë, përdoruesi e merr nga ujërat sipërfaqore, deri në 80 Lekë/m<sup>3</sup> (0.63€/m<sup>3</sup>) për përdorimin e ujit për pishina, ujë i cili merret nga ujërat nëntoksore.

Në Shqipëri sipas raportimeve në OECD, të ardhurat nga ngarkesat ujore e përdorimit të ujit dhe nga ngarkesat e nxjerrjes së materjaleve inerte nuk figurojnë (Tabela 2). Nga pagesat e mbrojtjes së ujërave, në buxhetin e shtetit mesatarisht për një vit inkasohen 1,600,000.00 \$. Të dhënat për të ardhurat u referohen databazës nga OECD.<sup>20</sup>

Tabela 2: Të ardhurat nga pagesat e ujit në Shqipëri dhe krahasimi i me mesataren e rajonit

| Te ardhurat mesatare vjetore ne Shqiperi nga tarifat e ujit |                                |                      | Shteti             | Te ardhurat mesatare vjetore nga tarfat e ujit [€] |
|---|--------------------------------|----------------------|--------------------|--|
| Vitet   | Tarifa e mbrojtjes se ujit [€] |                      | Kosova             | 34,808.78  |
|   |                                |                      | Serbia             | 10,966,666.67                                      |
|   |                                |                      | Kroacia            | 22,395,833.33                                      |
|   |                                |                      | Sllovnia           | 29,296,710.53                                      |
|   |                                |                      | Mali i Zi          | 311,111.11   |
|   |                                | Total / mesatare [€] | Mesatarja ne rajon | 12,601,026.08                                      |
|   |                                |                      | %                  | 12.70  |
|   | 1                              | 1,600,000.00         |                    |  |
|   |                                | 1,600,000.00         |                    | 1,600,000.00                                       |

**Burimi:** Raportimet e shteteve ne databazen e OECD

#### 3.4. Sistemi i ngarkesave / pagesave të ujit në Maqedoni

Menaxhimi me ujërat është në kompetencë të organit të administrates shtetërore, në përjashim të qytetit të Prishtinës që janë organet e komunave të qytetit të Prishtinës. Territorin e Republikës së Maqedonisë e përbëjnë katër rajone të rrjedhave të lumenjve, dhe atë rajonet e rrjedhave të lumenjve Vardari, Drini i Zi, Strumica dhe Morava Jugore<sup>21</sup>.

<sup>19</sup> Republika e Shqipërisë, vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e tarifave (ngarkesave) të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta, [http://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/Draft\\_VKM\\_2\\_Ngarkesat\\_e\\_perdorimit\\_te\\_ujit.pdf](http://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/Draft_VKM_2_Ngarkesat_e_perdorimit_te_ujit.pdf)

<sup>20</sup> OECD, Database on Policy Instruments for the Environment.

[https://pinedatabase.oecd.org/All\\_Information.aspx?Keys=56dd5c20-a1e2-4f28-9b30-00f0654d552d&Ctry=39](https://pinedatabase.oecd.org/All_Information.aspx?Keys=56dd5c20-a1e2-4f28-9b30-00f0654d552d&Ctry=39)

<sup>21</sup> Sektori i Ujërave, Republika e Maqedonisë, [http://www.moep.gov.mk/?page\\_id=3967&lang=AL#](http://www.moep.gov.mk/?page_id=3967&lang=AL#)



| 3   | 12,500,000.00                   | 313,200,000.00                 | 17800000                         |                      |   |
| 4   | 17,600,000.00                   | 1,800,000.00                   | 19100000                         |                      |   |
| 5   | 17,600,000.00                   | 28,900,000.00                  | 22900000                         |                      |   |
| 6   | 22,600,000.00                   | 34,400,000.00                  | 23000000                         |                      |   |
| 7   | 22,600,000.00                   | 42,900,000.00                  | 13600000                         |                      |   |
| 8   | 20,800,000.00                   | 56,800,000.00                  | 13700000                         |                      |   |
| 9   | 30,200,000.00                   | 57,700,000.00                  |                                  |                      |   |
| 10  | 34,200,000.00                   | 57,600,000.00                  |                                  |                      |   |
| 11  | 32,000,000.00                   | 48,400,000.00                  |                                  |                      |   |
| 12  | 29,500,000.00                   | 47,100,000.00                  |                                  |                      |   |
| 13  |                                 | 48,900,000.00                  |                                  |                      |   |
| 14  |                                 | 7,900,000.00                   |                                  |                      |   |
| 15  |                                 | 43,400,000.00                  |                                  |                      |   |
| 16  |                                 | 45,300,000.00                  |                                  |                      |   |
| 17  |                                 | 38,300,000.00                  |                                  |                      |   |
| 18  |                                 | 38,100,000.00                  |                                  |                      |   |
| 19  |                                 | 37,300,000.00                  |                                  |                      |   |
| 20  |                                 |                                |                                  |                      |   |
|   | 21,250,000.00                   | 50,152,631.58                  | 16,487,500.00                    | Total / mesatare [€] | 29,296,710.53                                       |
|   |                                 |                                |                                  | Mesatarja ne rajon   | 7,061,683.98  |
|   |                                 |                                |                                  | %                    | 414.87  |

**Burimi:** Nga raportimet e shteteve në databazën e OECD

<sup>43</sup> OECD, Database on Policy Instruments for the Environment. [https://pinedatabase.oecd.org/All\\_Information.aspx?Keys=56dd5c20-a1e2-4f28-9b30-00f0654d552d&Ctry=39](https://pinedatabase.oecd.org/All_Information.aspx?Keys=56dd5c20-a1e2-4f28-9b30-00f0654d552d&Ctry=39)

### 3.8. Sistemi i ngarkesave / pagesave të ujit në Malin e Zi

Në Mal të Zi, rregullimi I fushës së ujërave dhe financimit të saj rregullohet përmes ligjeve si :

- Ligji i ujërave<sup>44</sup> dhe
- Ligji për financimin e menaxhimit të ujërave<sup>45</sup>

Bazuar në ligjet e lartpërmendura, sistemi i pagesave të ujit rregullohet përmes Vendimit mbi lartësinë dhe mënyrën e llogaritjes së ngarkesave ujore dhe kriteret dhe mënyrën e përcaktimit të shkallës së ndotjes së ujit.<sup>46</sup>

Lartësitë e ngarkesave së përdorimit të ujit është: për qëllime të pijes dhe shfrytëzimit 0,015 € / m3 ujë të furnizuar; për nevoja teknologjike 0,02 € / m3 ujë të përdorur; për ujitje të 0,004 € / m3 ujë të prekur; për mbushjen dhe paketimin e ujërave minerale dhe natyrore, 0,003 € / l shishe ose mbushur me ujë; për larje të enëve 0.02 € / m3 ujë; për shkarkimin ose dërgimin e ujit për qëllime komerciale 0,03 € / m3 ujë të furnizuar; për prodhimin e peshkut, krustaceve, predhave dhe ushqimeve të tjera deti: 0,01 € / kg të prodhuar ose , 0,005 € / kg trofte të prodhuara, 0,0075 € / kg specie të tjera të peshkut, 0,0025 € / kg predha të prodhuara dhe 0,01 € / kg të gaforreve të prodhuara dhe prodhimeve të tjera deti; për prodhimin e energjisë elektrike në pragun e centralit elektrik 0.0001 € / kWh, për përdorim uji në kushte shumë të favorshme natyrore duke përdorur hidrokorumulime prej 0,0006 € / m3, për të tjera përdor 0,00005 € / kW;

Ngarkesa për përdorimin e ujit llogaritet duke shumëzuar ngarkesën (tarifën) gjejgjësisht tarifën (për njësi të masës) me shumën e kompezimit të përmendur. Ligji për Financimin e Menaxhimit të Ujërave ka përcaktuar që financimi i menaxhimit të ujit sigurohet nga taksat e ujit, ngarkesat për marrjen e të drejtave të ujit, taksa për dhënien me qira të burimeve publike të ujit dhe objekteve dhe sistemeve të ujit, si dhe donacioneve dhe burime të tjera, në përputhje me ligjin.

Ngarkesat e ujit paguhen për:

<sup>44</sup> Ligji i Ujit ne Republikën e Malit të Zi, “Zakon o vodama”, <https://www.paragraf.me/propisi-crnegore/zakon-o-vodama.html>

<sup>45</sup> Ligji për financimin e menaxhimit të ujit ne Republikën e Malit të Zi, “Zakon o Finansiranju Upravljanja Vodama” <http://extwprlegs1.fao.org/docs/pdf/mne151778.pdf>

<sup>46</sup> Vendimi për shumën dhe mënyrën e llogaritjes së tarifave të ujit dhe kriteret dhe mënyrën e përcaktimit, “Odluka o visini i načinu obračunavanja vodnih naknada i kriterijumima i načinu utvrđivanja” <http://www.upravazavode.gov.me/biblioteka/odluke>



- përdorimin e ujit,
- mbrojtjen e ujërave nga ndotja, dhe
- materialin e nxjerrë nga rrjedha ujore.

### **Ngarkesa (tarifa) e përdorimit të ujit**

Ngarkesa e shfrytëzimit të ujit deri më tani është rregulluar me Ligjin për Ujërat e vitit 1996, ngarkesa ujore është shprehur në përqindje në raport me çmimin e shitjes së ujit për 1 m<sup>3</sup>. Ngarkesa për përdorimi i ujit për prodhimin e energjisë elektrike, në të dyja bazat para hyrjes në fuqi Ligji për Ujin nga viti 1996 është rregulluar me Ligjin për Energjinë. Vendimi përcakton shumën e taksës për shfrytëzimin e ujit gjatë koncesioneve ngarkesat përcaktohen me rregullore të veçanta. Ngarkesa është e ndryshme dhe përcaktohet në varësi nga qëllimi i përdorimit të ujit. Ngarkesa ujore paguhet për 1 m<sup>3</sup> të të dhënave të prekura, të përdorura, ujë të derdhur ose të holluar, për 1 litër ujë të ambalazhuar ose të mbushur, për 1 kg peshk të prodhuar, krustaceve, butakëve dhe të tjerëve. ushqim deti, ose sasia e energjisë së prodhuar në prag termocentralet, termocentralet ose sipërfaqen e akumulimit të hidrocentraleve. Akumulimi i hidrokarbureve llogaritet sipas volumit të akumulimit të ujit ose pjesës së tij të përcaktuar nga dokumentacioni teknik, nën të cilin është jashtëzakonisht e favorshme natyrore kushtet përfshijnë kushtet hidrogeologjike të terrenit, të cilat mundësojnë formimin akumulimi i ujit.

### **Ngarkesa (tarifa) për mbrojtjen e ujërave nga ndotja**

Ngarkesa për mbrojtjen e ujërave nga ndotja deri më tani është rregulluar me Vendimin mbi kriteret dhe mënyra e pagesës së ngarkesave për mbrojtjen e ndotjes së ujit, kompezimi për të nxjerrë materiale nga rrjedhat ujore dhe ngarkesat për shfrytëzimin e objekteve të menaxhimit të ujit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Malit të Zi", nr. 15/96 dhe 35/98), i cili përcaktonte se ngarkesa është llogaritur në 1 m<sup>3</sup> lëshuar ujërave të zeza. Vendimi ka përcaktuar ngarkesat për mbrojtjen e ujërave nga ndotja. Baza për përcaktimin e ngarkesës së ndotjes për ujërat ndotëse të çojë marrësit ose të dëmtojë cilësinë e tyre dhe kushtet e përdorimit në pajtim me Ligjin mbi financimi i menaxhimit të ujit është sasia e ujërave të zeza të shkarkuar dhe shkalla e saj.

Kriteret për përcaktimin e shkallës së ndotjes së ujit përcaktohen në Vendim dhe me një metodë për llogaritjen e kompezimit për ndotësit e ujit nuk kryejnë matjet e përshtuara të

cilësisë së ujërave të zeza në varësi të ndikimit të aktivitetit tatimpaguesit për ndotjen e ujit të marrësit.

Për prodhimin ose importimin e plehrave minerale, produkteve kimike për mbrojtjen e bimëve dhe Detergjentët e bazuar në fosfat, ngarkesa llogaritet për 1 kg mallra të prodhuara ose të importuara, për menaxhimin e porteve për 1t ngarkesë, si dhe për menaxhimin e marinave sipas numrit të vendeve në varësia nga lloji i anijes. Në pajtim me Ligjin për Ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Malit të Zi", Nr. 27/07), kompezimi për mbrojtjen e ujit nga ndotja nga porti dhe marina i referohet ndotjes së ujit bregdetare nga toka, e cila ka origjinën nga magazinimi dhe transbordimi i mallrave, magazinimit dhe furnizimin e anijeve me vajra minerale dhe largimin e ujërave të ndotura, të naftës dhe të tjerëve çështje nga anijet, në dallim nga ngarkesat e paguar sipas rregullave të zones çështjet detare dhe lidhet me ndotjen e detit nga anijet dhe anijet e tjera.

#### **Ngarkesa për materialin e nxjerrë nga rrjedha e ujit**

Ngarkesa (tarifa) për materialin e nxjerrë nga rrjedhat ujore është rregulluar me vendimet e lartepërmendura mbi kriteret, shumën dhe mënyrën e pagesës së kompezimit për mbrojtjen e ndotjes së ujit, kompezimi për materialet e nxjerra nga rrjedhat e ujit dhe ngarkesat për përdorimin e objekteve të menaxhimit të ujit.

Vendimi përcakton shumën e kompezimit për materialin e nxjerrë nga rrjedha ujore. Ngarkesat paguhet për 1 m<sup>3</sup> të nxjerrë rërë, zhavorr, gur ose material tjetër nga luginat e rrjedhave ujore, zburimet, luginat e braktitura dhe nga brigjet e rrjedhave ujore natyrore, natyrore dhe rezervuarët artificiale dhe zonat e rrezikuara nga erozioni.

Neni 11 i këtij vendimi përcakton që shuma e garkesave të ujit do të korrigjohet me rritjen e çmimit në nivel vjetor, në të njëjtën përqindje, sipas të dhënave të organit administrativ të autoritetit kompetent për statistika.

Për shkak të urgjencës, ky vendim u zbatua, që nga dita e zbatimit të Ligjit për financimi i menaxhimit të ujërave, Vendimi mbi kriteret, lartësinë dhe metodën ka pushuar së qeni i vlefshëm pagesa e kompezimit për ndotjen e ujit nga ndotja, kompezimi për materialet e nxjerra nga rrjedhat e ujit dhe ngarkesat për përdorimin e objekteve të menaxhimit të ujit.

Për zbatimin e vendimit nuk është e nevojshme të sigurohen fonde nga Buxheti I Malit të Zi, por arkëtimi i këtyre pagesave nga ngarkesat ujore do të jenë të ardhura në buxhetin e Malit të Zi dhe buxhetet do të realizohen në njësi të vetëqeverisjes lokale.

Pajtueshmëria me legjislacionin evropian dhe ndërkombëtarët e konfirmuar Konventat. Vendimi është në përputhje me Direktivën 2000/60 / EC për krijimin e një kornize për veprim Politikat Komunitare të Ujërave (Direktiva Kuadër e BE-së për Ujëra). Neni 9 i Direktivës Kornizë të BE-së për Ujë parashikon politikat e çmimit të ujit ofrojnë stimuj adekuat për përdoruesit e ujit për të përdorur në mënyrë racionale burimet ujore dhe duke kontribuar kështu në objektivat mjedisore, në përputhje me parimin "ndotësi paguan".

Mali i Zi është më afër Kosovës dhe Shqipërisë sa i takon të ardhurave mesatare vjetore të garkesave ujore (Tabela 6). Ky vend i rajonit 500 mijë \$ i inkason mesatarisht në vit nga ngarkesa (tarifa) e shfrytëzimit të ujit. Rreth 167 mijë nga pagesa e mbrojtjes së ujit dhe rreth 267 mijë \$ nga inertet. Në përgjithsi mesatarja e të hyrave nga ngarkesat e tri kategorive, në Mal të Zi, është 311 mijë euro në vit. Kjo vlerë arrin në 2.42 % të mesatares së të ardhurave të rajonit. \$. Të dhënat për të ardhurat u referohen databazës nga OECD.<sup>47</sup>

Tabela 6. Të ardhurat nga pagesat e ujit në Mal të Zi dhe krahasimi me mesataren e rajonit

| Te ardhurat mesatare vjetore ne Mal te zi nga tarifat e ujit |                                  |                                 |                                      |                       | Shteti             | Te ardhurat mesatare vjetore nga tarifat e ujit [\$] |
|--|----------------------------------|---------------------------------|--------------------------------------|-----------------------|--------------------|--|
| Vitet  | Tarifa e perdorimit te ujit [\$] | Tarifa e mbrojtjes se ujit [\$] | Pagesa per nxjerrjen e inerteve [\$] | Total / mesatare [\$] |                    |  |
| 1  | 200,000.00                       | 100,000.00                      | 400,000.00                           |                       | Kosova             | 34,808.78  |
| 2  | 400,000.00                       | 100,000.00                      | 200,000.00                           |                       | Shqiperia          | 1,600,000.00   |
| 3  | 900,000.00                       | 300,000.00                      | 200,000.00                           |                       | Serbia             | 10,966,666.67  |
|  | 500,000.00                       | 166,666.67                      | 266,666.67                           | <b>311,111.11</b>     | Kroacia            | 22,395,833.33  |
|  |                                  |                                 |                                      |                       | Slllovia           | 29,296,710.53  |
|  |                                  |                                 |                                      |                       | Mesatarja ne rajon | 12,858,803.86  |
|  |                                  |                                 |                                      |                       | %                  | 2.42   |

**Burimi:** Nga raportimet e shteteve ne databazen e OECD

#### 4. Dallimet e vendeve të rajonit sipas të ardhurave vjetore nga ngarkesat e ujit

Dallimet e vendeve të rajonit sipas të ardhurave vjetore nga ngarkesat e ujit janë kryesisht nga ngarkesat e përdorimit të ujit, mbrojtjes së ujërave dhe nxjerrja e inerteve, varësisht nga politikat e vendeve të caktuara. Në tabelën 7 dhe grafikun nr.1 shihet se mesatarja e

<sup>47</sup>OECD, Database on Policy Instruments for the Environment.


[https://pinedatabase.oecd.org/AllInformation\\_Result.aspx?Key=da2887f4-83d3-499c-bb03-055ced9847fc&Keys=56dd5c20-a1e2-4f28-9b30-00f0654d552d&Ctry=45](https://pinedatabase.oecd.org/AllInformation_Result.aspx?Key=da2887f4-83d3-499c-bb03-055ced9847fc&Keys=56dd5c20-a1e2-4f28-9b30-00f0654d552d&Ctry=45)

të ardhurave në vendet e rajonit është 12,914,064.33 \$. Kosova nuk qëndron mirë sa i përket të hyrave nga ngarkesat e ujit (vetëm 34,808.78 \$ në vit, mesatarisht arrin t'i arkëtojë në buxhetin e shtetit, që i bie 0.27 % të të hyrave nga mesatarja e shteteve të rajonit. Vendi që prin në mbushjen e arkës së shtetit është Sllovenia me një mesatare vjetore prej 29,296,710.53 \$. As Kroacia nuk qëndron aq larg Sllovenisë që është me mesatare vjetore prej 22,395,833.33 eurosh. Në vendin e tretë, shikuar në krahasimet e këtyre vendeve, është Serbia me 10,966,666.67 \$ vjetore mesatare dhe tri vendet e fundit janë: Shqipëria, Mali i Zi dhe Kosova e fundit.

Tabela 7. Të ardhurat mesatare vjetore dhe krahasimet e mesatares së rajonit

| Vendi     | Te ardhurat mesatare vjetore nga tarfat e ujit [\$] | % e mesatares se rajonit |
|-----------|---|--------------------------|
| Kosova    | 34,808.78   | 0.27                     |
| Shqipëria | 1,600,000.00  | 12.7                     |
| Serbia    | 10,966,666.67                                       | 102.23                   |
| Kroacia   | 22,395,833.33                                       | 265.3                    |
| Sllovenia | 29,296,710.53                                       | 414.87                   |
| Mali i Zi | 311,111.11  | 2.42                     |

Grafiku 1: Të ardhurat mesatare vjetore dhe krahasimet e mesatares së rajonit



## 5. Struktura e ngarkesave (tarifave) mesatare të ujit në rajon

Në shtetet e rajonit, në tabelat e mëposhtme mund të shohim çfarë garkesa për shfrytëzimin e ujit dhe mbrojtjen e ujit aplikojnë shtetet<sup>48</sup> si: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Bosnja, Kroacia, Sllovenia dhe Mali i Zi.<sup>49</sup>

<sup>48</sup> Rregulloret/vendimet/dekretet e secilit shtet veç e veç.

<sup>49</sup> Lartësia e pagesave në vendet e rajonit KNMU

### 6. Ngarkesat e përdorimit/shfrytëzimit të ujit në rajon

Nga Tabela 8 dhe Grafikoni 2 shihet se Kosova i ka pothuajse të gjitha ngarkesat ujore më të ulta krahasuar me rajonin. Në ngarkesën e përdorimit të ujit Kroacia prinë në lartësin e pagesës për shfrytëzimin e ujit. Ndërsa në lartësinë e pagesës më të ulët është Kosova e pasur nga Sërbia. Sa i përket ngarkesës (tarifës) së ambalazhimit të ujit (shih Grafikonin 3), vendet me ngarkesë më të ulët se Kosova (1.00 EURO/m<sup>3</sup>) janë Shqipëria (0.068 EURO/m<sup>3</sup>) dhe Sllovenia (0.092 EURO/m<sup>3</sup>). Përderisa Sërbija ka ngarkesën më të lartë të ambalazhimit të ujit ambalazhimit në rajon (10.00 EURO/m<sup>3</sup>). Sa i përket ngarkesave ujore tjera (shih Tabelen 8.) është vështirë të krahasohem doke qenë se vendet në rajon përdonin njësi të ndryshme të matjes (Për hektar, m<sup>2</sup>, përqindje, kilogram etj). Maqedonia veqohet sepse të ngarkesat ujore i ka të kalkuruara ne përqindje.


Tabela 8: Ngarkesat e shfrytëzimit (përdorimin) te ujit

| VENDI       | VENDI | Përdorimi i ujit për furnizim me ujë të pijes/tarifa mesatare/konvertuar në [€/m <sup>3</sup> ] | Përdorimi i ujit për ambalazhim te ujit natyral dhe mineral/tarifa mesatare/konvertuar në [€/m <sup>3</sup> ] | Përdorimi i ujit për ujitje/tarifa mesatare/konvertuar në [ha/€/m <sup>3</sup> & m <sup>2</sup> ] | Perdorimi i ujit per kultivim peshku/tarifa mesatare/konvertuar në [€/m <sup>3</sup> /kg] | Perdorimi i ujit per prodhimin e energjise hidro dhe termo/tarifa mesatare/konvertuar në Euro / % e çmimit të shitur |
|-------------|-------|---|---|---|---|--|
| Kosova      | KS    | 0.002   | 1   | 5.83  | 0.03  | 2.1  |
| Shqipëria   | Al    | 0.007   | 0.068   | 3.17  | 0.012   | 1.66   |
| Maqedonia** | MK    | 2%  | 0.50%   | 2%  | 3%  | 0.75   |
| Serbia      | SRB   | 0.0028  | 10  | 5.75  | 0.00019   | 2.3  |
| Bosna       | B&H   | 0.054   | 1.08  | 0   | 0   | 0  |
| Kroacia     | CRO   | 0.099   |   | 67.47   | 0   | 6.25   |
| Sllovenia*  | SLO   | 0.064   | 0.092   | 0.068   | 0.001   | 0.007  |
| Mali i Zi   | MNE   | 0.015   | 3   | 0.004   | 0.005   | 0.0006   |


\* Sllovenia ngarkesën për përdorimin e ujit për ujitje e llogarit me njësinë metër kub [m<sup>3</sup>]

\*\* Maqedonia këtë ngarkesë e llogaritë në përqindje [%]

Grafiku 2: Ngarkesat për përdorimin e ujit për ujë të pijshëm



Grafiku 3: Ngarkesat për përdorimin e ujit për ambalzhim të ujit natyral dhe mineral



### 7. Ngarkesat e mbrojtjes së ujit në rajon


Nga tabela 9 dhe Grafiku 4 shihet se ngarkesat për ujërat e ndotura urbane në vendet si: Kroacia, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova, luhaten në kufijtë: vlera minimale është 0.001 Euro për metër kub [€/m³], vlera maksimale 0.12 [€/m³], ndërsa vlera është mesatare 0.03 [€/m³].

Pra, vërehet se të të gjitha vendet e marra në konsideratë gjatë këtij studimi tregojnë se kanë ngrkesa (tarifa) më të larta se sa ato në territorin e Republikës së Kosovë.

Tabela 9. Ngarkesat për ujërat e ndotura (zeza) në vendet e rajonit


| Shteti            | Ujërat e ndotura urbane [€/m³] | Ujërat e përdorura në industrinë e naftës, metalurgjisë së zeze dhe të ngjyrosur, etj. e mishit, serviset e automjeteve etj [€/m³] | Ujërat e përdorura në industritë tjera [€/m³] | Per nxjerrjen e inerteve [€/m³] | Per procesin e ftohjes [€/m³] |
|-------------------|--------------------------------|--|---|---------------------------------|-------------------------------|
| <b>Slllovenia</b> |                                |  |   |                                 |                               |
| <b>Kroacia</b>    | 0.12                           | 0.12   | 0.12  |                                 | 0.0012                        |
| <b>Serbia</b>     | 0.0017                         | 0.043  | 0.024   | 0.49                            |                               |
| <b>B&amp;H</b>    |                                |  | 1.02  | 0.75                            |                               |
| <b>Mali i Zi</b>  | 0.006                          | 0.006  | 0.006   | 2.75                            |                               |
| <b>Kosova</b>     | 0.001                          | 0.03   | 0.02  | 1.5                             |                               |

Grafiku 4: Ngarkesat për ujërat e ndotura urbane sipas vendeve të rajonit



Nga Grafiku 5, shihet se ngarkesat për ujërat e ndotura të cilat shkarkohen pas procesit të përdorimit në industrinë e naftës, metalurgjisë së zezë dhe të ngjyrosur, etj., mishit, serviset e automjeteve etj., në vendet si: Kroacia, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova, luhaten në kufijtë: vlera minimale është 0.006 Euro për metër kub [€/m<sup>3</sup>], vlera maksimale 0.12 [€/m<sup>3</sup>], ndërsa vlera është mesatare 0.050 [€/m<sup>3</sup>]. Pra, nga fig.x. vërehet se në Republikën e Kosovës kjo ngarkesë tarifore është me e vogël (ulët) se sa në Kroaci dhe Serbi, ndërsa është më e lartë se në Mal të Zi.


Grafiku 5: Ngarkesat për ujërat e përdorura në industri



Nga Grafiku 6, shihet se ngarkesat për ujërat e ndotura të cilat shkarkohen nga industritë e tjera në vendet si: Kroacia, Serbia, Bosna dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Kosova, luhaten në kufijtë: vlera minimale është 0.006 Euro për metër kub [€/m<sup>3</sup>], vlera maksimale 1.02 [€/m<sup>3</sup>], ndërsa vlera është mesatare 0.23 [€/m<sup>3</sup>]. Pra, vërehet se në Republikën e Kosovës

kjo ngarkesë është me e vogël (ulët) se sa në Kroaci, Serbi, Bosne dhe Hercegovinë, ndërsa është më e lartë se në Mal të Zi.


Grafiku 6: Ngarkesat për ujërat e përdorura në industritë e tjera



Nga Grafiku 7, shihet se ngarkesat për nxjerrjen e inerteve (rërë, zhavorr, dhe, gurë etj.) në vendet si: Serbia, Bosna dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Kosova, luhaten në kufijtë: vlera minimale është 0.49 Euro për metër kub [€/m<sup>3</sup>], vlera maksimale 2.75 [€/m<sup>3</sup>], ndërsa vlera është mesatare 1.37 [€/m<sup>3</sup>]. Pra, vërehet se në Republikën e Kosovës kjo ngarkesë është me e madhe (lartë) se sa në Serbi dhe Bosne dhe Hercegovinë, ndërsa është më e vogël (ulët) se në Mal të Zi. Prandaj, mund të themi se marrë në përgjithësi rrjetin hidrografik, si dhe mundësin për formimin e depozitave të formacioneve aluviale në shtretër dhe birigjet e lumenjve, vlersohet se kjo ngarkesë është e pranueshme për të bërit biznes në Republikën e Kosovës.



Grafiku 7: Ngarkesat për nxjerrjen e inerteve



Sa i takon ngarkesës ujore i cili përdoret në procesin e ftohjes bazuar në të gjeturat gjatë këtij hulumtimi rezulton se vetem shteti Kroat e ka të rregulluar këtë ngarkesë (tarifë) e cila është 0.0012 [€/m<sup>3</sup>], ndërsa vendet tjera të marra në konsiderat gjatë hartimit të këtij raporti hulumtuese nuk e kanë të rregulluar.

## V. KAPITULLI III

### 8. Përlllogaritja / Analiza e ngarkesave për përdorimin e ujit, mbrojtjen e ujit dhe nxjerrjen e materialeve inerte

#### 8.1. Kategorizimi dhe klasifikimi i ngarkesave ujore në rajon

Pas krahasimit të lartësisë së pagesave të ujit nëpër vendet e rajonit dhe dallimeve tarifore (ngarkesave ujore) për kategoritë e instrumenteve ekonomike ujore të përcaktuara me legjislacionet në fuqi dhe hartimit të politikave shtetërore, edhe Kosova sikur vendet tjera duhet të harton një mekanizëm funksional dhe institucional të sistemit të pagesave të ujit. Vendet e rajonit të cilat janë analizuar janë : Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Bosna, Kroacia, Sllovenia dhe Mali i zi. Të hyrat nga pagesat e ujit të gjitha këto vende i kanë të kategorizuara në 3 grupe, prej të cilave janë të strukturuar sipas specifikave të bazuara në politikat dhe ligjet e vendeve të caktuara.<sup>50</sup>

Përveç të drejtës ujore që procedohet përmes koncesionit, kategoritë kryesore të ngarkesave ujore me të cilat veçohen të gjitha vendet e rajonit janë :

- Ngarkesat për përdorimin e ujit
- Ngarkesat për mbrojtjen e ujit dhe
- Ngarkesat për nxjerrjen e materialeve inerte

#### 8.2. Ngarkesat për përdorimin e ujit

Në parim, ngarkesa për përdorimin e ujit është uji i cili merret nga burimet e ndryshme dhe shfrytëzohet për destinime të caktuara si:

- Furnizim publik,
- Për nevoja teknologjike,
- Ambalazhim i ujit netyral dhe mineral si dhe pijeve alkoolike dhe joalkoolike
- Ujitje të tokave
- Kultivim të peshkut dhe llojeve të tjera të ujit
- Prodhim të hidro dhe termo energjisë
- Të tjera

<sup>50</sup> OECD, Database on Policy Instruments for the Environment.  
[https://pinedatabase.oecd.org/All\\_Information.aspx?Keys=56dd5c20-a1e2-4f28-9b30-00f0654d552d&Ctry=45](https://pinedatabase.oecd.org/All_Information.aspx?Keys=56dd5c20-a1e2-4f28-9b30-00f0654d552d&Ctry=45)

### 8.3. Ngarkesa për mbrojtjen e ujit

Ngarkesa (tarifa) për mbrojtjen e ujit nënklasifikohet në:

- Ujërat e përdorura në procesin tekniko-teknologjik për përpunimin dhe qarkullimin e naftës dhe derivateve të naftës,
- metalurgjisë së zezë,
- metalurgjisë së ngjyrosur,
- industrisë së tekstilit,
- industrisë së letrës,
- lëkurës, fermave,
- thertoreve dhe industrisë së mishit,
- serviseve të automjeteve dhe makinave
- Ujërat nga Industritë tjera të pacekura më lart
- Ujërat urbane të cilat mblidhen në sistemet e kanalizimit
- Ujërat për ftohje në termocentralet me sistem të hapur të ftohjes
- Të tjera

### 8.4. Ngarkesa për nxjerrjen e materjaleve inerte

Ngarkesa (tarifa) për nxjerrjen e materjaleve inerte ndahet në :

- Ngarkesën për nxjerrjen e gurëve, rëres dhe zhavorrit nga shtretërit dhe brigjet e lumenjve të cilat nuk përmbajnë substanca të tjera të dobishme
- Ngarkesën për nxjerrjen e gurëve rërës dhe zhavorrit nga tokat e degraduara
- Ngarkesa tjera për nxjerrjen e materialeve inerte

## 9. Analiza e treguesve/parametrave ekonomik dhe mjedisor të vendeve të rajonit dhe krahasimi i tyre

Treguesit të cilët janë marrë objekt hulumtimi në analizë janë:

- Treguesit / parametrat ekonomik të vendeve ( popullsia, sipërfaqja, të ardhurat bruto dhe neto, GDP nominale dhe PPP në total, GDP nominale dhe PPP për kokë banori etj)
- Treguesit / parametrat mjedisor ( disponueshmeria mesatare e ujit për kokë banori në vit, trifat e ujesjellesve dhe kanalizimeve, përqindja e ujit etj )

Tabela 10: Parametrat ekonomikë dhe mjedisorë në rajon

| VENDI     | Nr. Banorëve | S [km <sup>2</sup> ] | Valuta      | GDP (PPP) Totale në [Bilion] | GDP (PPP) për Capita [S] | GDP (Nominal) Total [\$/ Bilion] | GDP (Nominal) për Capita [S] | Uji [%] | Tarifat e ujësjellësit [m <sup>3</sup> /S] | Tarifat e kanalizimit [m <sup>3</sup> /S] | Paga mesatare bruto [€] | Paga mesatare neto [€] | Sasia e ujit ne dispozicion/km <sup>3</sup> / vit/per capita |
|-----------|--------------|----------------------|-------------|------------------------------|--------------------------|----------------------------------|------------------------------|---------|--|---|-------------------------|------------------------|--|
| Kosova    | 1,907,592    | 10,908               | Euro        | 22.41                        | 12003                    | 7.73                             | 4140                         | 1.0     | 0.46                                       | 0.1                                       | 519                     | 457                    | 1.6  |
| Shqipëria | 2,893,005    | 28,748               | Leku        | 38.154                       | 13274                    | 15.289                           | 5319                         | 4.7     | 0.47                                       | 0.16                                      | 408                     | 375                    | 43   |
| Maqedonia | 2,103,721    | 25,713               | Denari      | 33.196                       | 15977                    | 12.292                           | 5916                         | 1.9     | 0.57                                       | 0.52                                      | 422                     | 372                    | 6.4  |
| Serbia    | 7,040,272    | 77,474               | Dinari      | 112.475                      | 16063                    | 42.378                           | 6052                         |         | 0.61                                       | 0.26                                      | 516                     | 374                    | 162.2  |
| Bosna     | 3,856,181    | 51,129               | Marka konv. | 45.858                       | 13442                    | 18.56                            | 4836                         | 1.4     | 0.75                                       | 0.23                                      | 669                     | 428                    | 37.5   |
| Kroacia   | 4,154,200    | 56,594               | Kuna        | 106.548                      | 25807                    | 61.056                           | 14788                        | 1.09    | 1.74                                       | 0.66                                      | 0                       | 0                      | 105.2  |
| Sllovenia | 2,066,880    | 20,273               | Euro        | 75.604                       | 36566                    | 56.933                           | 27535                        | 0.7     | 1.2  | 1.53                                      | 0                       | 0                      | 31.9   |
| Mali i Zi | 642,550      | 13,812               | Euro        | 11.381                       | 18261                    | 4.02                             | 6424                         | 2.6     | 1.01                                       | 0.52                                      | 751                     | 499                    |  |


Burimi: IMF, WM, OEDD, ASK dhe IBNET

(<https://tariffs.ibnet.org/sites/IBNET/VisualSearch?weight=0&ServiceId=3&YearId=0&perPage=50>)

### 9.1. Popullsia

Treguesi i popullsisë apo numrit të banorëve në rajon dhe krahasueshmëria mes vendeve të rajonit tregon se mesatarja e popullsisë në rajon është 3,083,050 banorë. Shteti me numër më të vogël të popullsisë është Mali i Zi, pastaj është Kosova dhe shteti me numrin më të madh të banorëve është Serbia dhe e dyta radhitet Kroacia.


Tabela 11: Popullsia e vendeve te rajonit



### 9.2. Siperfaqja

Sa I përket sipërfaqes, në 8 vendet e rajonit, vendi me sipërfaqe më të madhe përsëri është Sërbia dhe më pas radhitet Kroacia. Ndërsa vendi me sipërfaqe më të vogël është Kosova dhe Mali i Zi. Mesatarja e sipërfaqes në rajon është 35,581 km<sup>2</sup>.

Tabela 12: Sipërfaqja e vendeve te rajonit



### 9.3. GDP nominal dhe PPP në total dhe për capita

GDP (Gross Domestic Product/Produkti i Brendshëm Bruto) është vlera e përgjithshme e tregut të të gjitha mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në një vend në një periudhë të caktuar. Secili vend i raporton të dhënat e veta në monedhën e vet. Për të krahasuar të dhënat, statistikatat e secilit vend duhet të konvertohen në një monedhë të përbashkët. Dy metodat më të zakonshme për të kthyer GDP-në në një monedhë të përbashkët janë pariteti nominal dhe fuqia blerëse (PPP).


Vlerësimet nominale të GDP-së përdoren zakonisht për të përcaktuar gjendjen ekonomike të një vendi apo rajoni të tërë dhe për të bërë krahasime ndërkombëtare. Është koncepti origjinal i PBB-së. Në metodën nominale, kurset e këmbimit të tregut përdoren për konvertim. Nuk merr parasysh dallimet në koston e jetesës në vende të ndryshme. Lulahatjet në kurset e këmbimit të monedhës së vendit mund të ndryshojnë renditjen e një vendi nga një vit në tjetrin, edhe pse shpesh nuk bëjnë pak ose aspak ndryshim në standardin e jetesës së popullsisë së saj.

Për nevojat e këtij raporti dhe me qëllim të përcaktimit të ngarkesave ujore në Kosovë, është analizuar raporti në mes të indikatorëve ekonomik dhe instrumenteve ekonomike mjedisore/ujore. GDP (PPP) totale në Miliardë dhe Per Capita dhe GDP (Nominal) në Miliardë dhe Per Capita të paraqitura në tabelë nr. 13 dhe Grafiku nr. 8 pasqyrojnë dallimet në mes të 8 vendeve të rajonit. Kosova në të gjitha rastet është e fundit apo e parafundit pas malit të zi ( tek GDP (PPP) totale dhe the GDP (Nominale ). Në të gjitha rastet GDP e Kosovës është nën 50% të mesatares së rajonit përveç tek GDP Per Capita të PPP. Mesatarja e 4 llojeve të GDP në Kosovë, krahasuar me mesataren e rajonit është 44.04 %.

Tabela 13: GDP në total dhe Per Capita – Nominale dhe PPP (Krahasimi me mesataren e rajonit)


| VENDI                                      | GDP (PPP)<br>Totale në<br>[\$/Bilion] | GDP (PPP)<br>Per Capita [\$] | GDP (Nominal)<br>Total [\$/<br>Bilion] | GDP<br>(Nominal)<br>Per Capita<br>[\$] |
|--|---------------------------------------|------------------------------|--|--|
| Kosova                                     | 22.41                                 | 12003                        | 7.73                                   | 4140                                   |
| Shqipëria                                  | 38.154                                | 13274                        | 15.289                                 | 5319                                   |
| Maqedonia                                  | 33.196                                | 15977                        | 12.292                                 | 5916                                   |
| Serbia                                     | 112.475                               | 16063                        | 42.378                                 | 6052                                   |
| Bosna                                      | 45.858                                | 13442                        | 18.56                                  | 4836                                   |
| Kroacia                                    | 106.548                               | 25807                        | 61.056                                 | 14788                                  |
| Sllovenia                                  | 75.604                                | 36566                        | 56.933                                 | 27535                                  |
| Mali i Zi                                  | 11.381                                | 18261                        | 4.02                                   | 6424                                   |
| Mesatarja                                  | 55.70                                 | 18924.13                     | 27.28                                  | 9376.25                                |
| Kosova ne mesatare te rajonit ne perqindje | 40.23                                 | 63.43                        | 28.33                                  | 44.15                                  |

Grafiku 8: GDP në total dhe Per Capita – Nominale dhe PPP




Në rastin e krahasimit të GDP (PPP) dhe GDP (Nominale) totale në tabelle dhe grafik shohim se Kosova qëndron menjëherë pas Malit të Zi me një GDP totale të PPP prej 22.41 Bilion \$ dhe GDP Nominale totale prej 7.73 Bilion \$. GDP (PPP) më të lartë në rajon e ka Serbia me 112.475 Bilion \$ dhe GDP (nominale) totale më të lartë e ka Kroacia prej 61.056 Bilion \$. Me GDP (PPP) totale më të ulët radhitet e fundit Mali I Zi prej 11.381 Bilion \$ dhe me GDP (nominale) totale më të ulët është gjithashtu Mali I zi me vetëm 4.02 Bilion \$. Mesatarja e GDP (PPP) totale në rajon është 55.703 bilion \$ dhe mesatarja e GDP (nominale) totale në rajon është 27.28 Bilion \$.

Tabela 20: GDP në total – PPP dhe Nominale



Krahasimi i GDP (PPP) dhe GDP (Nominale) Per Capita në tabelle dhe grafik shohim se Kosova e fundit me një GDP Per Capita të PPP prej 12,003 \$ dhe GDP Nominale Per Capita prej 4,140 \$. GDP (PPP) Per Capita më të lartë në rajon e ka Sllovenia me 36,566 \$ dhe GDP (nominale) Per Capita më të lartë e ka gjithashtu Sllovenia me 27,535 \$. Me GDP (PPP) Per Capita dhe me GDP (nominale) Per Capita më të ulët është Kosova. Mesatarja e GDP (PPP) Per Capita në rajon është 18,924.13 \$ dhe mesatarja e GDP (nominale) Per Capita në rajon është 9,376.25 \$.

Tabela 14: GDP Per Capita – PPP dhe Nominale



#### 9.4. Ngarkesat e ujësjellesit dhe kanalizimit Ngarkesat e Shërbimit

Bazuar në Ligin Nr. 05/L – 042, ARRU përcakton tarifën e shërbimit për ofruesit e shërbimeve, duke siguruar që tarifën të jenë të drejta, të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve.

ARRU cakton tarifa për:

- Shërbimet e ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura
- Shërbimet e furnizimit të ujit të pa-trajtuar me shumicë
- Tarifa të ujit të trajtuar me shumicë.<sup>51</sup>

Tarifa përcaktohet nga kërkesa për të ardhura pjesëtuar me vëllimin e ujit të shitur (përshtatur për efikasitetin në arkëtimin e të ardhurave). Kërkesa për të ardhura është e përbërë nga tri komponente kryesore: (1) Shpenzimet operative; (2) Mirëmbajtja kapitale dhe (3) Kthimi në Bazën Rregullatore të Aseteve.

### **Proceset Tarifore**

Para vitit 2009 ngarkesat për furnizimit me ujë dhe ngarkesat për ujëra të ndotura përcaktoheshin çdo vit mbi bazën e të dhënave historike financiare, e që përdreshin si përcaktues kryesor i nevojave financiare për vitin pasues.<sup>52</sup>

Në vitin 2008 ARRU fillon procesin e parë të shqyrtimit 3 vjeçar të tarifave (2009-2011), i cili bazohej në projeksione larg-pamëse të shpenzimeve, investimeve kapitale dhe lejimit për kthim në kapital të mjaftueshëm për të tërhequr investitorët në sektor. Ngarkesat ujore ishin vendosur paraprakisht mbi nivelet e çmimeve të vitit bazë (2008) për tre vitet e periudhës së shqyrtimit.<sup>53</sup>

Në vitin 2011 ARRU përmirëson procesin tarifor 2012-2014, duke zhvilluar një Biznes Plan Rregullator i cili ishte më i lehtë për t'u përdorur, si dhe është përmirësuar baza e raportimit të të dhënave. Proceset tarifore të radhës janë vazhdimësi e metodologjisë tarifore të viteve 2012-2014, ku janë bërë modifikime të nevojshme në BPRR dhe në formatin e raportimit.

### **Krahasueshmëria e tarifave të ujit dhe kanalizimit në rajon**

<sup>51</sup> Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), Tarifat e Shërbimit, <http://www.arru-rks.org/ngarkesat/318/ngarkesat-e-sherbimit/318>

<sup>52</sup> Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), Proceset Tarifore, <http://www.arru-rks.org/al/ngarkesat/465/procesi-tarifor/465>

<sup>53</sup> Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), Proceset Tarifore, <http://www.arru-rks.org/al/ngarkesat/465/procesi-tarifor/465>



Rrjeti Ndërkombëtar i Benchmarking për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimeve (IBNET) është qasja e drejtpërdrejtë në bazën më të madhe të të dhënave botërore të të dhënave të performancës së tarifave të ujit dhe kanalizimeve.<sup>54</sup>

Me tarifatat të cilat ngarkohen konsumatorët përmes sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit të vendeve të rajonit nga tabela dhe grafiku nr. 15 shihet se Kosova ka tarifën më të ulët në rajon për të dyja llojet ( uje dhe kanalizim ). Mesatarja e tarifës së ujësjellësit në rajon është 0.85 m<sup>3</sup>/€ ndërsa për kanalizim mesatarja është 0.50 m<sup>3</sup>/€. Në Kosovë tarifa e ujësjellësit të cilën paguajnë konsumatorët për 1 m<sup>3</sup> është 0.46€ që është 54.04% e çmimit mesatar të mësatares së rajonit. Ndërsa tarifa e kanalizimit është vetëm 20.10% e çmimit të mesatares së rajonit. Në rajon sa I përket tarifës së ujësjellësit, shteti me tarifën më të lartë është Kroacia me 1.74 \$ për 1 m<sup>3</sup> dhe shteti me tarifën më të lartë të kanalizimit është Sllovenia me 1.53 \$ për 1 m<sup>3</sup>.

Tabela 15: Ngarkesat e ujësjellësit dhe kanalizimit në vendet e rajonit

| VENDI     | Tarifat e ujësjellësit [m <sup>3</sup> /€] | Tarifat e kanalizimit [m <sup>3</sup> /€] |
|-----------|--|---|
| Kosova    | 0.46                                       | 0.1                                       |
| Shqipëria | 0.47                                       | 0.16                                      |
| Maqedonia | 0.57                                       | 0.52                                      |
| Serbia    | 0.61                                       | 0.26                                      |
| Bosna     | 0.75                                       | 0.23                                      |
| Kroacia   | 1.74                                       | 0.66                                      |
| Sllovenia | 1.2  | 1.53                                      |
| Mali i Zi | 1.01                                       | 0.52                                      |

### 9.5. Paga mesatare në Kosovë dhe vendet e Rajonit

Pagat janë një ndër treguesit më të rëndësishëm për ta vlerësuar fuqinë blerëse. Derisa, për ta vlerësuar standardin jetësor të popullsisë së atij vendi/rajonit ndikojnë edhe faktorë të tjerë (kostot e ndryshëm të pagesave, si dhe çmimet e tregut).<sup>55</sup>

#### Paga mesatare bruto dhe neto

Nga 6 shtetet e rajonit pagat bruto dhe neto mesatare variojnë nga 408 Euro Shqipëria deri në 751 euro Mali I zi për pagën bruto mesatare dhe nga 372 euro Maqedonia deri ne 499 euro Mali i zi për pagën neto. Në këtë krahasim, parametër i pagave mesatare nuk është

<sup>54</sup> Tariff Benchmarking, Tariff comparison based on a consumption of 15m<sup>3</sup> per month. Average tariffs per country weighted by population, <https://tariffs.ib-net.org/sites/IBNET/VisualSearch?weight=0&ServiceId=3&Yearid=0&perPage=50>

<sup>55</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Statistikat Sociale, Niveli i pagave në Kosovë 2012 – 2016, Faqe 13, <http://ask.rks-gov.net/media/3671/niveli-i-pagave-n%C3%AB-kosov%C3%AB-2012-2016-date-20112017-wfinal.pdf> (faqe 13).

prezantuar për Kroacinë dhe Slloveninë si dy vende tani më të BE-së. Paga mesatare e këtyre 6 vendeve të rajonit është 553.2 euro bruto paga dhe 409.6 euro neto paga. Kosova ka pagën mesatare bruto 6.18 % më të ulët se paga mesatare e rajonit ndërsa 11.57 % më të lartë se paga neto e mesatares së rajonit. Dmth sa I përket pagës mesatare bruto dhe neto, Kosova qëndron në korelacion me vendet e rajonit.

Tabela 16: Paga mesatare bruto dhe neto në vendet e rajonit

| VENDI     | Paga mesatare bruto [€] | Paga mesatare neto [€] |
|-----------|-------------------------|------------------------|
| Kosova    | 519                     | 457                    |
| Shqipëria | 408                     | 375                    |
| Maqedonia | 422                     | 372                    |
| Serbia    | 516                     | 374                    |
| Bosna     | 669                     | 428                    |
| Mali i Zi | 751                     | 499                    |

### 9.6. Disponueshmëria e ujit në vendet e rajonit

Treguesi kryesor (Tabela 17) në analizën e krahasimit mes vendeve të rajonit është disponueshmëria mesatare afatgjatë e ujit për një vend në kilometra kub të reshjeve, ujit nëntoksorë dhe hyrjeve sipërfaqësore nga vendet përreth brenda 1 viti.<sup>56</sup>

Tabela 17: Disponueshmëria mesatare e ujit në kilometra kub të reshjeve, ujit nëntoksorë , ujrat në hyrje dhe largimi i ujërave

| Vendi | Reshjet (mm/vit) | TARWR Vëllimi 2005 (km <sup>3</sup> / vit) | Tarif Per Capita 2000 (m <sup>3</sup> / yr) | Tarif Per Capita 2005 (m <sup>3</sup> / vit) | Sipërfaqja e ujit% TARWR | Ujërat nëntoksorë TARWR | Ujërat në hyrje të TARWR | Largimi <sup>3</sup> ujërat% TARWR |
|-------|------------------|--|---|--|--------------------------|-------------------------|--------------------------|------------------------------------|
| KS    | 700              | /  | /   | /  | /                        | /                       | /                        | /                                  |
| AL    | 1000             | 42   | 13306                                       | 13060  | 55%                      | 15%                     | 35%                      | 0%                                 |
| MKD   | 600              | 6  | 3 147                                       | 3 100  | 84%                      | 0%                      | 16%                      | 100%                               |
| SRB   | /                | /  | /   | 19 820                                       | 20%                      | 1                       | 79%                      |                                    |
| B&H   | 1000             | 38   | 9429  | 8960   | /                        | /                       | /                        | 100%                               |
| CRO   | 1 100            | 106  | 22 669                                      | 23 890                                       | 26%                      | 10%                     | 64%                      | 38%                                |
| SLO   | 1 200            | 32   | 16 031                                      | 16 080                                       | 58%                      | 42%                     | 41%                      | 60%                                |
| MNE   | /                | /  | /   | /  | /                        | /                       | /                        | /                                  |


**Burimi:** Green Facts, Informacion mbi disponueshmërinë e ujit, “Water availability information”, <https://www.greenfacts.org/en/water-resources/figtableboxes/3.htm>

Parametri kryesor ne tërë analizën dhe krahasimin e vendeve të rajonit është disponueshmëria e ujit ne mesatare vjetore për kokë banori (Tabela 18). Në tabelë dhe grafik shihet se si

<sup>56</sup> Green Facts, Informacion mbi disponueshmërinë e ujit, “Water availability information”, <https://www.greenfacts.org/en/water-resources/figtableboxes/3.htm>

radhiten vendet e rajonit në këtë aspekt. Kosova dukshëm është me nivelin më të ulët të ujit në dispozicion me një mesatare prej 1.6 km<sup>3</sup> në vit për kokë banori. Pas Kosovës, me nivel të ulët të disponueshmërisë së ujit radhitet Maqedonia. Në vendin e parë në rajon, me prurjet me të larta, km<sup>3</sup> të reshjeve, ujërave nëntoksore dhe sipërfaqësore qëndron Serbia me 162.2 km<sup>3</sup> për kokë banori.

Tabela 18. Sasia e ujit për kokë banori në vendet e rajonit



## VI. KAPITULLI IV

### 10. Verzioni i Draft – Rregullore për ngarkesat ujore

#### RREGULLORE PËR STRUKTURËN E PAGESAVE TË UJIT

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Në pajtim me nenin 91 (1) të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (GZ, Nr. 10, me datë 29 Prill 2013), si dhe nenin 19 (6.2) të Rregullores të Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (GZ, Nr. 15, 12.09.2011),

Miratton:

RREGULLOREN (QRK) NR. \_\_\_\_\_ PËR STRUKTURËN E PAGESAVE TË UJIT

## Neni 1

## Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohet lartësia e pagesës për shfrytëzimin e ujërave, shkarkimin e ujërave të ndotura dhe kompezimi për nxjerrjen e inerteve nga shtretërit dhe brigjet e ujërrjedhave si dhe metoda e llogaritjes, procedurat, afatet dhe kontrolli i detyrimeve.

**I. Lartësia e pagesave të ujit**

## Neni 2

Pagesa për përdorimin/shfrytëzimin e ujit, mbrojtjen e ujërave dhe nxjerrjen e materjaleve inerte nga shtretërit dhe brigjet e ujërrjedhave, do të ketë për bazë parimin “Shfrytëzuesi dhe ndotësi paguan”

## Neni 3

## Pagesa për shfrytëzimin e ujit

1. Pagesa e shfrytëzimit të ujërave për furnizim me ujë të pijshëm për:
  - a) Ujërat e pa trajtuara të cilat merren drejtpërdrejt është 0.0010 € për 1 m<sup>3</sup>;
  - b) Ujërat të cilat janë të kualitetit të ujërave për pije dhe merren për shitje personave juridik është 0.0021 € 1m<sup>3</sup>
  - c) Ujërat të cilat janë të kualitetit të ujërave për pije dhe merren për shitje qytetarëve është 0.0021 € 1m<sup>3</sup>;
  - d) Ujërat të cilat janë të kualitetit të ujërave për pije dhe merren për nevoja vetjake është 0.0021 € 1m<sup>3</sup>;
2. Pagesa e shfrytëzimit të ujërave për prodhuesit të cilët ambalazhojnë :
  - a) Ujërat mineral dhe ujërat natyrale është 0.9344 € për 1 m<sup>3</sup> ose 0.0093 për 1 Litër të shitur;
  - b) Pijet alkoolike dhe joalkoolike është 0.9344 € për 1 m<sup>3</sup>
3. Pagesa e shfrytëzimit të ujërave për ujitjen e tokave bujqësore me ujë nga:
  - a) Liqenet artificiale është 4.2648 € për një ha;

- b) Ujërrjedhat ose burimet natyrore është 4.2648 € për një ha;
  - c) Ujërat nëntoksore është 4.2648 € për një ha
4. Pagesa e shfrytëzimit të ujërave për kultivimin e peshqve (organizmave) ujqor është 0.1175 € për çdo kilogram peshku të shitur/ ose 0.0300 € për 1 m<sup>3</sup>
5. Pagesa e shfrytëzimit të ujërave për prodhuesit e energjisë elektrike për çdo kilovat-orë të prodhuar në
- a) Hidrocentral është 2.5 % e çmimit të shitur dhe
  - b) Termocentral është 1.7 % të çdo kilovat-orë të prodhuar në termocentralet me sistem të mbyllur të ftohjes

#### Neni 4

Rastet për të cilat detyruesi, lirohet nga pagesa e ujit janë kur :

1. përdorimi i ujit nga burimi i ujit të pijshëm furnizon me ujë më pak se 50 njerëz dhe burimi i ujit nuk është i përfshirë në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm publik në përputhje me rregullat e qeverisjes komunale për mbrojtjen e mjedisit, shërbimet dhe furnizimin me ujë;
2. shuma vjetore e abstraksionit të burimeve të ujit nuk i kalon 2,500 m<sup>3</sup> dhe burimi i ujit nuk është i përfshirë në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm publik në përputhje me rregullat e qeverisjes komunale për mbrojtjen e mjedisit, shërbimet dhe furnizimin me ujë;
3. shuma vjetore e ujit të abstraksionit burimeve për ujitjen e tokave bujqësore nuk kalon 4000 m<sup>3</sup> ;
4. për prodhimin e energjisë elektrike në hidrocentrale deri në 10 MW, nëse energjia potenciale e ujit në dispozicion për prodhimin e energjisë është në përputhje me të drejtat e fituara të ujit në vit dhe nuk kalojnë prodhimin prej 10 MWh dhe
5. për prodhimin e ngrohjes, kur energjia është në dispozicion për nxjerrjen e nxehtësisë nga uji, jo më shumë se 10 MWh,

## Neni 5

## Pagesa për mbrojtjen e ujit

1. Pagesa për shkarkimin e ujërave të përdorura (ndotura) përcaktohet për:
  - a) Ujërat e përdorura në procesin tekniko-teknologjik për përpunimin dhe qarkullimin e naftës dhe derivateve të naftës, metalurgjisë së zezë, metalurgjisë së ngjyrosur, industrisë së tekstilit, industrisë së letrës, lëkurës, fermave, thertoreve dhe industrisë së mishit, serviseve të automjeteve dhe makinave është 0.0327 € për 1 m<sup>3</sup>;
  - b) Ujërat nga Industritë tjera të përcaktuara më lart është 0.0243 € për 1 m<sup>3</sup>;
2. Pagesa për shkarkimin e ujërave të përdorura (ndotura) përcaktohet për:
  - a) Ujërat urbane të cilat mbledhen në sistemet e kanalizimit është 0.0025 € për 1 m<sup>3</sup>;
  - b) Llojet tjera të ujërave të përdorura është 0.0273 € për 1 m<sup>3</sup>;
  - c) Ujërat për ftohje në termocentralet me sistem të hapur të ftohjes është 0.0327 € për 1 m<sup>3</sup>

## Neni 6

Në qoftë se detyruesit nga paragrafi 1) dhe 2) të nenit 4 shkarkojnë ujëra të përdorura (ndotura) në kanalizimin publik, paguan kompezimin në shkallë të përcaktuar për kategorinë të cilës i takon. Shkalla e kompezimit rritet varësisht nga shkalla e ndotjes së mjedisit pritës në:

- Klasa e II 70%
- Klasa e III 40%

## Neni 7

1. Në rastet kur detyruesi i pagesës së kompezimit shkarkon ujërat e pastruara në impiantin për pastrimin dytësor dhe pastrimi bëhet pa ndërprerë gjatë gjithë vitin paguan:
  - a) 80 % të kompezimit të paraparë, nëse me pastrim zvogëlohet përqëndrimi i materieve ndotëse për 60% nga ato të parapara me projektin e pastrimit të ujërave të përdorura.

- b) 70 % të kompezimit të paraparë në se me pastrim zvogëlohet përqëndrimi i materieve ndotëse për 70% nga ato të parapara me projektin e pastrimit të ujërave të përdorura
  - c) 30% të kompezimit të paraparë nëse me pastrim zvogëlohet përqëndrimi i materieve ndotëse për 90% nga ato të parapara me projektin e pastrimit të ujërave të përdorura.
2. Pastrim parësor në kuptim të kësaj Rregullore nënkupton mënjanimin vetëm të disa materieve ndotëse (gjësendet notuese, rëra, yndyrat, vajrat etj).

#### Neni 8

1. Në rastet kur detyruesi i pagesës së kompezimit shkarkon ujërat e pastruara në impiantin për pastrimin parësor kurse pastrimi bëhet pa ndërpre gjatë gjithë vitin paguan:
  - a) 40% të lartësisë së paraparë me nenin 2 të kësaj Rregullore, në qoftë se, me pastrimin e ujërave zvogëlohen pëqëndrimet e materieve ndotëse për 50%, nga sasia e paraparë me projektin për pastrimin e ujërave të ndotura;
  - b) 30% të lartësisë së paraparë me nenin 2 të kësaj Rregullore në qoftë se me pastrimin e ujërave zvogëlohen koncentrimet e materieve ndotëse për 70% nga sasia e paraparë me projektin për pastrimin e ujërave të ndotura;
  - c) 10% të lartësisë së paraparë me nenin 2 të kësaj Rregullore në qoftë se me pastrimin e ujërave zvogëlohen përqëndrimet e materieve ndotëse për 85% nga sasia e paraparë me projektin për pastrimin e ujërave të ndotura;

#### Neni 9

Detyruesi nuk paguan nëse posedon impiante për pastrimin e ujërave të cilat pastrojnë ujërat e ndotura të cilat pas shkarkimit në mjedisin pritës nuk ndryshojnë klasën e përcaktuar për rrjedhën meritore (ekologjikisht të pranueshme).

#### Neni 10

Pagesa për nxjerrjen e materjaleve inerte

1. Pagesa për nxjerrjen e :
  - a) Gurëve rëres dhe zhavorrit nga shtretërit dhe brigjet e lumenjve të cilat nuk përmbajnë substanca të tjera të dobishme bëhet në shumë prej 1.1814 € për 1 m<sup>3</sup>.

- b) Gurëve rërës dhe zhavorrit nga tokat e degraduara bëhet në shumë prej 1.1814 € për 1 m<sup>3</sup>.

#### Neni 11

Pagesën nga paragrafi a) dhe b) të nenit 10 detyruesi e paguan duke u bazuar në raportin për sasinë e nxjerra të cilin ia dërgon Ministrisë.

Pagesën nga paragrafi a) dhe b) të nenit 10 nuk paguhet në qoftë se materialet përdoren për përmirësimin e regjimit ujqor.

## **II. Metoda e llogaritjes, , procedurat, afatet dhe kontrolli i detyrimeve**

#### Neni 12

Në rastet kur detyruesi nuk posedon paisjet për matjen e ujërave të shfrytëzuara ose të shkarkuara, paguan kompenzimin në bazë të të dhënave nga dokumentacioni teknik për lartësinë maksimale të cilat kërkohen ose shkarkohen në proces me kapacitet të plotë.

#### Neni 13

Zvogëlimi i pagesës sipas nenit 4 të kësaj Rregullore bëhet me kërkesë të detyruesit për shkarkimin e ujërave të ndotura (përdorura) e cila duhet të jetë e dokumentuar me analiza nga personi i autorizuar për lëshuarjen e atestit të cilësisë së ujërave.

#### Neni 14

Detyruesi për pagesën për shfrytëzimin e ujërave nga neni 3 të kësaj Rregullore, pagesën e bën për çdo muaj më së voni deri me datën 15 të muajit në vijim.

Detyruesi në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (këtu e tutje: Ministrinë) ose institucionin të cilin e autorizon ajo bënë korrigjimin e pagesës për çdo tre muaj.

#### Neni 15



Detyruesi për pagesën për shkarkimin e ujërave të ndotura (përdorura) nga neni 5 të kësaj Rregullore, pagesën e bën për çdo muaj më së voni deri me datën 15 të muajit në vijim.

Detyruesi në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (këtu e tutje: Ministrinë) ose institucionin të cilin e autorizon ajo bënë korigjimin e pagesës për çdo tre muaj.

#### Neni 16

Zvogëlimi i pagesës bëhet me kërkesë të detyruesit për nxjerrjen e inerteve të cilës duhet ti bashkangjiten të dhënat gjeologjike dhe procesverbalin e inspektorit ujqor.

#### Neni 17

Forma e raportimit nga detyruesi për kompezimin sipas kësaj Rregullore rregullohet me leje ujqore:

Nëse detyruesi nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1 i këtij neni organi kompetent i cili e lëshon lejen ujqore, në çdo kohë e ka të drejtën e revokimit;

Autoriteti i Pellgut Lumor dhe Komunat janë të detyruara që një herë brenda vitit përkatësisht sipas kërkesës ti raportojnë Ministrisë për të gjitha të hyrat financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Rregullore.

#### Neni 18

Përlllogaritjen dhe ngarkimin e obligimit sipas kësaj Rregullore e bën Ministria respektivisht Autoriteti i Rajonit të Pellgut Lumor në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

#### Neni 19

Kontrollet për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje duhet të kryhen nga inspektorët e ujqit

#### Neni 20

Mbledhjen e mjeteve financiare sipas kësaj rregullore e bënë Administrata Tatimore e Kosovës

#### Neni 21

Mjetet e realizuara sipas kësaj Rregullore janë të ardhura të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

#### Neni 22

Të gjithë detyruesit të cilët deri në hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore nuk i kanë kryer detyrimet, obligohen që brenda afatit prej pesë (5) vitesh të kryejnë detyrimet e parapara me Udhëzimin Administrativ Nr.06/2006 dhe Udhëzimin Administrativ 02/2016.

#### Neni 23

Qeveria e Republikës së Kosovës, më propozim të ARPL ka të drejtë çdo vit të ndryshoj lartësinë e pagesave pa ndryshuar përmbajtjen e rregullores.

Ndryshimi i ngarkesave ujore propozohet në fund të vitit aktual, për vitin e ardhshëm dhe aprovet me vendim të Qeverisë së Kosovës.

#### Neni 24

Kjo rregullore i shfuqizon dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.06/2006 dhe Nr. 02/2016 për Strukturën e Pagesave të Ujit, përveç dispozitave që vazhdojnë të zbatohen sipas nenit 23 të kësaj Rregullore.

#### Neni 25

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Kryeministrit

Ramush Haradinaj

\_\_\_\_\_  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Data \_\_\_\_\_



## 11. Referencat

- Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), tarifat e Shërbimit, <http://www.arru-rks.org/ngarkesat/318/ngarkesat-e-sherbimit/318>
- Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), Proceset Tarifore, <http://www.arru-rks.org/al/ngarkesat/465/procesi-tarifor/465>
- Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), Proceset Tarifore, <http://www.arru-rks.org/al/ngarkesat/465/procesi-tarifor/465>
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Statistikat Sociale, Niveli i pagave në Kosovë 2012 – 2016, Faqe 13, <http://ask.rks-gov.net/media/3671/niveli-i-pagave-n%C3%AB-kosov%C3%AB-2012-2016-date-20112017-wfinal.pdf>
- Economic instruments as tools for water management in the transition towards a green economy [http://www.un.org/waterforlifedecade/green\\_economy\\_2011/pdf/session\\_1\\_economic\\_instruments.pdf](http://www.un.org/waterforlifedecade/green_economy_2011/pdf/session_1_economic_instruments.pdf).
- Green Facts, Informacion mbi disponueshmërinë e ujit, “Water availability information”, <https://www.greenfacts.org/en/water-resources/figtableboxes/3.htm>
- Green Facts, Informacion mbi disponueshmërinë e ujit, “Water availability information” <https://www.greenfacts.org/en/water-resources/figtableboxes/aquastat2.htm>
- Green Facts, Informacion mbi disponueshmërinë e ujit, “Water availability information” <https://www.greenfacts.org/en/water-resources/figtableboxes/aquastat2.htm>
- Green Facts, Informacion mbi disponueshmërinë e ujit, “Water availability information” <https://www.greenfacts.org/en/water-resources/figtableboxes/aquastat107.htm>
- Green Facts, Informacion mbi disponueshmërinë e ujit, “Water availability information” <https://www.greenfacts.org/en/water-resources/figtableboxes/aquastat155.htm>
- Green Facts, Informacion mbi disponueshmërinë e ujit, “Water availability information” <https://www.greenfacts.org/en/water-resources/figtableboxes/aquastat155.htm>
- Green Facts, Informacion mbi disponueshmërinë e ujit, “Water availability information” <https://www.greenfacts.org/en/water-resources/figtableboxes/aquastat155.htm>
- Green Facts, Informacion mbi disponueshmërinë e ujit, “Water availability information” <https://www.greenfacts.org/en/water-resources/figtableboxes/aquastat155.htm>
- Green Facts, Informacion mbi disponueshmërinë e ujit, “Water availability information” <https://www.greenfacts.org/en/water-resources/figtableboxes/aquastat45.htm>
- Green Facts, Informacion mbi disponueshmërinë e ujit, “Water availability information” <https://www.greenfacts.org/en/water-resources/figtableboxes/aquastat160.htm>
- Ligjit për Ujërat e Kosovës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.10, 29 prill 2013, Prishtinë). <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8659>
- LIGJI Nr. 04/L-147 PËR UJËRAT E KOSOVËS, Kapitulli 12, Financimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>
- LIGJI Nr. 04/L-147 PËR UJËRAT E KOSOVËS, Neni 85-92: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>

- LIGJI Nr. 111/2012 PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE, <http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2030/LIGJ%20nr.%206-2018,%20date%208.2.2018.pdf>
- Ligji i ujrave ne Maqedoni, “Zakon o Vodama”, <http://www.rdvode.gov.rs/doc/dokumenta/zakoni/zakon-o-vodama.pdf>
- Ligji i ujrave ne Bosnje dhe Herzegovinë (neni 71), “Zakon o Vodama” <http://www.voda.ba/zakoni/47bos.pdf>
- Ligji i Ujit ne Kroaci, “Zakon o vodama”, <http://www.voda.hr/hr/zakoni>
- Ligji i Ujit ne Slloveni, “Zakon o vodah (ZV-1)”, <http://pisrs.si/Pis.web/pregledPredpisa?id=ZAKO1244>
- Ligji për financimin e menaxhimit të ujit ne Republikën e Malit të Zi, “Zakon o Finansiranju Upravljanja Vodama” <http://extwprlegs1.fao.org/docs/pdf/mne151778.pdf>
- Ligji i Ujit ne Republikën e Malit të Zi, “Zakon o vodama”, <https://www.paragraf.me/propisi-crnegore/zakon-o-vodama.html>
- Ministria E Mjedisit Dhe Planifikimit Hapesinor (MMPH, raport për gjendjen e ujërave në republikën e kosovës, 2015, [https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti\\_i\\_ujrave\\_i\\_2015\\_shqip\\_\(2\).pdf](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_ujrave_i_2015_shqip_(2).pdf)
- OECD, Database on Policy Instruments for the Environment. [https://pinedatabase.oecd.org/All\\_Information.aspx?Keys=56dd5c20-a1e2-4f28-9b30-00f0654d552d&Ctry=39](https://pinedatabase.oecd.org/All_Information.aspx?Keys=56dd5c20-a1e2-4f28-9b30-00f0654d552d&Ctry=39)
- OECD, Database on Policy Instruments for the Environment. [https://pinedatabase.oecd.org/AllInformation\\_Result.aspx?Key=da2887f4-83d3-499c-bb03-055ced9847fc&Keys=56dd5c20-a1e2-4f28-9b30-00f0654d552d&Ctry=45](https://pinedatabase.oecd.org/AllInformation_Result.aspx?Key=da2887f4-83d3-499c-bb03-055ced9847fc&Keys=56dd5c20-a1e2-4f28-9b30-00f0654d552d&Ctry=45)
- Odluka o visini posebnih vodnih naknada, <http://www.voda.ba/odluka-o-visini-posebnih-vodnih-naknada>
- Raport I Auditimit, 2016, faqe 16, <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/07/RaportiAuditimit.MMPH.2016.Shqip.693321.pdf>
- Republika e Shqipërisë, vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta, [http://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/Draft\\_VKM\\_2\\_Ngarkesat\\_e\\_perdorimit\\_te\\_ujit.pdf](http://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/Draft_VKM_2_Ngarkesat_e_perdorimit_te_ujit.pdf)
- Rregullorja për lartësin e kompezimit të ujit,”Uredba o visini naknade za vodu”, Macedonia <http://www.rdvode.gov.rs/doc/dokumenta/podzak/Uredba%20o%20visini%20naknade%20za%20vode.pdf>
- Strategjina Shtetërore e Ujërave në Kosovës (SSHUK), Të ardhurat e sektorit të ujërave, faqe 51. [http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia\\_Shteterore\\_e\\_Ujrave\\_shqip.pdf](http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Shteterore_e_Ujrave_shqip.pdf)
- Sektori i Ujërave, Republika e Maqedonisë, [http://www.moep.gov.mk/?page\\_id=3967&lang=AL#](http://www.moep.gov.mk/?page_id=3967&lang=AL#)
- Struktura Kroate e Ujërave, “Ustroj, Ustrojstvo Hrvatskih voda” <http://www.voda.hr/hr/ustroj>
- Tariff Benchmarking, Tariff comparison based on a consumption of 15m<sup>3</sup> per month. Average tariffs per country weighted by population, [net.org/sites/IBNET/VisualSearch?weight=0&ServiceId=3&Yearid=0&perPage=50](http://net.org/sites/IBNET/VisualSearch?weight=0&ServiceId=3&Yearid=0&perPage=50)

- Të ardhurat nga pagesat e ujit, 2017,  
[http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Te\\_ardhurat\\_nga\\_pagesat\\_e\\_ujit.doc](http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Te_ardhurat_nga_pagesat_e_ujit.doc)
- Ngarkesat e ujit ne republikën e Kroacisë, “Vodne Naknade”, <http://www.voda.hr/hr/vodne-naknade>
- UDHËZIM ADMINISTRATIV QRK-Nr. 02/2016 PËR STRUKTURËN E PAGESAVE TË UJIT, neni 9 parag.1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15081>
- Urdhëresa për mënyrën e llogaritjes, procedurave dhe afatet për llogaritjen dhe pagesën dhe kontrollin e përmbushjes së detyrimeve sipas tarifës së përgjithshme të ujit dhe tarifave të veçanta të ujit. “Pravilnik o načinu obračunavanja, postupku i rokovima za obračunavanje i plaćanje i kontroli izmirivanja obveza na temelju opće vodne naknade i posebnih vodnih naknada”, <http://www.voda.ba/pravilnik-o-nacinu-obracunavanja>
- Urdhëresa për ndryshimin e Rregullores për mënyrën e pagesës së të hyrave nga buxheti publik dhe fondet e daljes në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës . “Pravilnik o izmjenama i dopunama Pravilnika o načinu uplate javnih prihoda budžeta i vanbudžetskih fondova na teritoriji Federacije Bosne i Hercegovine” <http://www.voda.ba/pravilnik-o-izmjenama-i-dopunama-pravilnika>
- Vendimet e Qeverisë: Vendim nr. 13/06. Vendimet e Mbledhjes së 6-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017.  
[http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_së\\_6-të\\_të\\_Qeverisë\\_së\\_Republikës\\_së\\_Kosovës\\_2017..pdf](http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_së_6-të_të_Qeverisë_së_Republikës_së_Kosovës_2017..pdf)
- Vendimet e Qeverisë: Vendim nr. 15/33. *Vendimet e Mbledhjes së 33-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2018.*  
[http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimi\\_i\\_Mbledhjes\\_së\\_33\\_-të\\_të\\_Qeverisë\\_së\\_Republikës\\_së\\_Kosovës\\_2018.pdf](http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimi_i_Mbledhjes_së_33_-të_të_Qeverisë_së_Republikës_së_Kosovës_2018.pdf)
- Vendimet e Qeverisë ne B&H,  
<https://www.mft.gov.ba/bos/images/stories/odluke/2017/20171009113849.pdf>
- Vendimi për shumën dhe mënyrën e llogaritjes së tarifave të ujit dhe kriteret dhe mënyrën e përcaktimit, “Odluka o visini i načinu obračunavanja vodnih naknada i kriterijumima i načinu utvrđivanja” <http://www.upravazavode.gov.me/biblioteka/odluke>

# SHTOJCA 1

*Llogaritja e ngarkesave ujore në bazë të investimeve (mbulimit të kostos së tyre) dhe koeficientëve të korigjimit sipas parametrave socioekonomik dhe mjedisor*

### Llogaritja e ngarkesave ujore në bazë të investimeve (mbulimit të kostos së tyre) dhe koeficientëve të korigjimit sipas parametrave socioekonomik dhe mjedisor

Ngarkesat për të gjitha kategoritë e pagesave të ujit janë llogaritur duke u bazuar në mbulimin e kostos së investimeve dhe shërbimeve të sektorit të ujërave në baza vjetore sipas parametrave socioekonomik dhe mjedisor. Burimet financiare të investimeve mesatare vjetore në fushën e ujërave sipas SSHUK janë si vijojnë :

|                                   |                         |
|-----------------------------------|-------------------------|
| Investimet nga Buxheti i Kosovës: | <b>11.6 MLN EUR</b>     |
| Investimet nga fondet e jashtme:  | <b>50.0 MLN EUR</b> dhe |
| Investimet nga ngarkesat ujore:   | <b>13.4 MLN EUR</b>     |
| <hr/>                             |                         |
| Gjithsej sipas SSHUK:             | <b>75.0 MLN EUR</b>     |

Investimet nga ngarkesat ujore janë kalkuluar sipas strukturës së ngarkesave ujore (tarifave) të parapara me Ligjin për Ujërat e Kosovës. Formulatat e përdorura për caktimin e ngarkesave ujore për secilën kategori të pagesave të ujit janë bazuar në pjesën e investimit (% e investimit ) të inkorporuar në ngarkesave ujore për mbulimin e kostos. Gjithashtu brenda formulës janë kalkuluar edhe koeficientët e korigjimit (parametrat e Kosovës në raport me mesataret e parametrave të rajonit).

Nga secila kategori e OE (operatorëve ekonomik) të cilët janë detyrues të pagesës për shfrytëzimin e ujit, mbrojtjen e ujit dhe nxjerrjen e materjaleve inerte, ngarkesave ujore është përlllogaritur në komulativ të shumës me të cilën mbulohet kosto e investimit.

Parametrat ekonomik – mjedisor të rajonit që janë konsideruar të rëndësishëm në kalkulimin e ngarkesave ujore në Republikën e Kosovës janë: GDP (PPP) dhe (Nominale) Per Capita , të ardhurat bruto dhe neto, disponueshëria e ujit për kokë banori dhe tarifatat (ngarkesat) e ujës-jellës/kanalizim të vendeve të rajonit.

Koeficientet e korigjimit të përlllogaritura brenda ngarkesës ujore së bashku më pjesën e përqindjes së investimeve përmes pagesave nga OE, kanë ndikuar që ngarkesat ujore për të gjitha llojet të jetë e arsyeshme, e argumentuar, optimale dhe e pranuar nga detyruesit për pagesë.



Nëse zberthehet ngarkesa për shfrytëzimin e ujit për furnizuesit publik, metoda përlllogaritjes së latësis së pagesës është si në vijim:

Investimet nga ngarkesat ujore në Total: **13.4 MLN EUR**

Përqindja (%) e investimit e mbuluar nga ngarkesa e shfrytëzimit të ujit për furnizuesit publik : **5%** (këtë përqindje e cakton MMPH )

Sasia e ujit që përdorin furnizuesit publik : **149,838,573 m<sup>3</sup>**

### Formula fillestare

---


$$T_{pu} = P_i / Q$$

T<sub>pu</sub>: Ngarkesa e përdorimit të ujit

P<sub>i</sub>: Pjesa e investimeve ( 5% )

Q: Sasia e ujit të shfrytëzuar nga furnizuesit publik

P<sub>i</sub> = 5% e vlerës 13.4 MLN EUR = 670,000 EUR

Q = 149,838,573 m<sup>3</sup>

T<sub>pu</sub> = 670,000 / 149,838,573

TPU = 0.0044 €

Vërejtje: Ngerkesa ujore prej **0.0044 €**, nuk është përfundimtare, duhet kalkuluar koficientët e korigjimit ( $k_1 * k_2 * k_3 * k_4 * k_5 * k_6 * k_7$ ).

### Formula përfundimtare $T_{pup} = T_{pu} \times$ koficientët korigjues ( $k_1 * k_2 * k_3 * k_4 * k_5 * k_6 * k_7$ )

---


$$T_{pup} = T_{pu} \times (k_1 * k_2 * k_3 * k_4 * k_5 * k_6 * k_7)$$

T<sub>pup</sub>: Ngarkesa e përdorimit të ujit sipas parametrave

T<sub>pu</sub>: Ngarkesa e përdorimit të ujit

k<sub>1</sub> – k<sub>7</sub>: koficientët e korigjimit (parametrat e Kosovës në raport me mesataret e parametrave të rajonit).

Parametrat janë të shndërruara në koficient janë :

- GDP (PPP) dhe (Nominale) Per Capita , (2 koficient – k<sub>1</sub> dhe k<sub>2</sub>)
- të ardhurat bruto dhe neto (2 koficient – k<sub>3</sub> dhe k<sub>4</sub>)
- ngarkesat e ujësjellës/kanalizim (2 koficient – k<sub>5</sub> dhe k<sub>6</sub>) dhe
- disponueshëria e ujit për kokë banori ( 1 koficient – k<sub>7</sub> )

- k1 – |0.4| GDP (PPP) Per capita
- k2 – |0.6| GDP (nominal ) Per capita
- k3 – |0.9| Te ardhurat bruto
- k4 – |1.1| Te ardhurat neto
- k5 – |0.5| Tarifa (ngarkesa) e ujësjellesit
- k6 – |0.2| Tarifa (ngarkesa) e kanalizimit
- k7 – |4.0| Disponueshmëria e ujit për kokë banori

Të gjithë koeficientët e sipërcekur nënkuptojnë parametrat e Kosovës në raport me mesataret e rajonit, të cilat përqindje janë vendosur sipas koeficientëve të korigjimit.

**Verejtje: Kjo metodet mundeson perlllogaritjenn e tatrifave edhe ne te ardhmen nese MMPH vendos ti korigjoj ato.**

$$Tpup = 0.0044 * 0.4 * 0.6 * 0.9 * 1.1 * 0.5 * 4$$

$$Tpup = 0.0021 \text{ €}$$

Ngarkesa e pëdorimit të ujit për furnizuesit e ujit e kalkuluar sipas të gjitha elementeve është: 0.0021 € për 1 m<sup>3</sup>

---

*Për të gjitha ngarkesat ujore tjera ecuria e është e njejtë në varësi nga rëndësia e parametrave që përcaktojnë ngarkesat ujore. Nuk është e domosdoshme që të gjithë parametrat / koeficientët të përlllogaritën në secilën ngarkesë ujore. Rëndësia e parametrave varet nga lloji i ngarkesës dhe caktohet koeficienti i korigjimit.*

# SHTOJCA 2

*Kalkulimi i ngarkesave ujore  
Tabela kryesore*

*Vërejtje: Tabelën mund ta gjeni edhe formatin EXCEL*